



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri:165

Tiranë – E Martë, 28 Tetor 2014

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 134/2014 datë 9.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	8319
Ligj nr. 135/2014 datë 9.10.2014	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit për kuadrin institucional të Iniciativës për Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave për Europën Juglindore.....	8325
Ligj nr. 136/2014 datë 9.10.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë - Hercegovinës për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.....	8329
Vendim i Kuvendit nr. 78/2014, datë 23.10.2014	Për miratimin e Raportit Përfundimtar të Komisionit Hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh me objekt “Shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj, për shkelje të rëndë të ligjit”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 70/2014.....	8334
Vendim i Kuvendit nr. 79/2014, datë 23.10.2014	Për shkarkimin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa.....	8335
Vendim i Kuvendit nr. 80/2014, datë 23.10.2014	Për shkarkimin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Lulzim Lelçaj.....	8335
Vendim i Kuvendit nr. 81/2014, datë 23.10.2014	Për miratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislationit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”.....	8335

Vendim i Kuvendit nr. 82/2014, datë 23.10.2014	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore .....	8336
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 15, datë 10.10.2014	Për shpërndarjen e financimit për projektet në vazhdim për arsimin, vaditjen dhe kullimin, artin dhe kulturën, infrastruktura vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve .....	8337
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 16, datë 10.10.2014	Për disa ndryshime në vendimet nr. 10, datë 9.7.2014, nr. 11, datë 1.8.2014 dhe nr. 14, datë 6.8.2014, shpërndarjen e financimit për shëndetësinë, projektet e thirrjes së katërt, si edhe shpalljen e thirrjes së pestë për infrastrukturën vendore.....	8343
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 49, datë 29.9.2014	Autorizim i ndihmës shtetërore për zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik, bazuar në ligjin nr. 116, datë 15.4.2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”...	8348
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 50, datë 1.10.2014	Plani i ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja “Start-up”” .....	8354
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 51, datë 1.10.2014	Plani i ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit në mbështetje të grave sipërmarrëse” .....	8356
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 52, datë 1.10.2014	Për skemën e ndihmës shtetërore “Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 20, datë 9.4.2013 “Për zbatimin e programit të zhvillimit ekonomik dhe punësimit “Skema e fondit të garancisë”, si dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë”” .....	8357



**LIGJ**  
**Nr. 134/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010,  
“PËR SEKTORIN MINERAR NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

**Neni 1**

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, fjalët “që mbulon çështjet” zëvendësohen me fjalët “përgjegjëse për veprimtarinë”.

2. Në pikën 3, fjalët “që mbulon çështjet” zëvendësohen me fjalët “përgjegjëse për veprimtarinë minerare”.

3. Në pikën 30, pas fjalës “social” shtohet fjala “mjedisor”.

4. Në pikat 34, 36 dhe 37 fjalët “të pranueshme për Ministrinë e Financave” zëvendësohen me fjalët “të nivelit të dytë në Shqipëri”.

5. Në pikën 39, në fjalinë e dytë, fjalët “dhe shfrytëzohen me leje” zëvendësohen me fjalët “ose shfrytëzohen me leje”.

6. Në pikën 40, fjala “realizuar” zëvendësohet me fjalën “hartuar”.

7. Pas pikës 40 shtohet pika 41 me këtë përmbajtje:

“41. “Ndryshim koordinatash” është zmadhimi, zvogëlimi apo rikonfigurimi i sipërfaqes së zonës së lejes minerare.”.

**Neni 2**

Në nenin 5, pika 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Për ushtrimin e të drejtave minerare, marrëveshja koncesionare e miratuar me ligj u nënshtrohet edhe përcaktimeve të këtij ligji, për aq

sa dispozitat e tij nuk bien në kundërshtim me parashikimet e marrëveshjes koncesionare.”.

**Neni 3**

Në nenin 9 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “b”, e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

“b) për zonat e hapura, në mundësinë e zbulimit të rezervave të reja minerare, interesin e veçantë të subjektit të licencuar për vazhdimin e shfrytëzimit në sipërfaqe dhe nëntokë ngjitur me konturet e lejes ekzistuese të tij, kur kanë mbaruar rezervat minerare brenda zonës së lejuar, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit. Procedurat, kriteret dhe rregullat për dhënien e miratimit për shfrytëzimin në sipërfaqe dhe nëntokë ngjitur me konturet e lejes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

2. Në pikën 2, fjalët “kërkim-zbulimit ose” shfuqizohen.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Objekti i dhënies së lejes së kërkim-zbulimit me procedurë konkurruese, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kur nuk ka kërkesa për leje shfrytëzimi, janë të gjitha zonat:

a) për të cilat nuk ka informacion gjeologjik;

b) për të cilat ka informacion gjeologjik, por ka interes për studim më të hollësishtëm dhe besueshmëri më të lartë në lidhje me të dhënat për zonën;

c) që u përkasin lejeve të kërkim-zbulimit, nëse në përfundim të afatit të tyre subjekti minerar, edhe pse ka zbuluar një sasi rezervash, nuk e ka kaluar në leje shfrytëzimi dhe ka interes për të vazhduar kërkim-zbulimin për këtë zonë, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe sasisë së rezervave;

ç) në minierat apo punimet e vjetra e të braktisura, për të cilat ka interes për studime ose saktësime në drejtim të rezervave minerare.

Për rastet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” afati maksimal i lejes së kërkim-zbulimit do të jetë deri në 1 vit.”.

**Neni 4**

Në nenin 13, pas pikës 13 shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:



“14. Të ketë personel të kualifikuar teknik gjatë gjithë kohëzgjatjes së lejes.”.

#### Neni 5

Në nenin 14 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka afat vlefshmërie 3-vjeçar. Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet 2 herë, me kërkesë të zotëruesit të lejes. Çdo zgjatje ka afat 1-vjeçar.”

2. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Afati i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e tij, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së kërkim - zbulimit.”.

#### Neni 6

Në nenin 15, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullisor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullisor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.”.

#### Neni 7

Në nenin 16 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Afati i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e tij, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit.”.

2. Në pikën 3, fjalët “për komunitetin e zonës përkatëse” zëvendësohen me fjalët “kombëtar ose lokal”.

3. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastin e një marrëveshjeje koncesionare, ministri negocion zgjatjen e afatit të marrëveshjes, sipas të gjithë objektit të saj, dhe propozon miratimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.”.

4. Në fund të pikës 5 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në marrëveshjet koncesionare, miratimi i zgjatjes së afatit të lejes minerare bëhet nga ministri, për aq sa zgjatja e këtij afati nuk bie në kundërshtim me ligjin për koncesionet dhe afatet kohore të marrëveshjes koncesionare, të miratuar me legjislacionin e posaçëm. Në çdo rast, leja minerare nuk mund të jetë me afat kohor më të gjatë se afati kohor i marrëveshjes koncesionare.”.

#### Neni 8

Në nenin 17, pika 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) të shfrytëzojë dhe të përpunojë mbetjet e veprimtarisë minerare, të prodhuara nga zona e vet, e lejuar për shfrytëzim. Në rastin kur zotëruesi i lejes minerare, në planet vjetore të veprimtarisë minerare, nuk shpreh interes për shfrytëzimin e mbetjeve, kjo e drejtë mund t'i kalojë një subjekti tjetër të interesuar, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.”.

#### Neni 9

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

#### **Nënkontraktimi**

1. Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë të përdorë nënkontraktorë për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, në funksion të realizimit të veprimtarisë minerare. Nënkontraktori i përzgjedhur duhet të jetë i specializuar në shërbimin për të cilin është kontraktuar nga zotëruesi i lejes minerare.

2. Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë të japë me nënkontraktim të drejtën e shfrytëzimit të lejes minerare, për kërkim - zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim - zbulim - shfrytëzim.

Nënkontraktori i përzgjedhur nga zotëruesi i lejes minerare duhet të marrë miratimin paraprak nga ministria, lidhur me plotësimin e kushteve ligjore, teknike e financiare. Kushtet dhe



procedurat e nënkontraktimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Zotëruesi i lejes minerare është përgjegjës përpara strukturave përgjegjëse për zbatimin e kushteve e të kërkesave të lejes minerare, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tjera, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Zotëruesi i lejes minerare dhe nënkontraktori janë përgjegjës përpara strukturave përgjegjëse për zbatimin e kushteve dhe rregullave të sigurimit teknik në zonën, në të cilën ushtrohet aktiviteti mineral i nënkontraktuar. Përgjegjësitë për zbatimin dhe respektimin e rregullave të sigurimit teknik përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar midis palëve.”

#### Neni 10

Në nenin 18, pika 1, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) të ketë personel të kualifikuar teknik gjatë gjithë kohëzgjatjes së lejes së shfrytëzimit.”

#### Neni 11

Në nenin 20, pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) të ketë personel të kualifikuar teknik gjatë gjithë kohëzgjatjes së lejes së kërkim - zbulimit.”

#### Neni 12

Në nenin 22 bëhen këto shtesa:

1. Në titull, pas fjalës “vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

2. Në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “njësitë e qeverisjes vendore” shtohen fjalët “ose institucioni, i cili menaxhon projekte me rëndësi kombëtare”.

b) Pas fjalëve “qëllime publike vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

3. Në pikën 3 bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “qëllime publike vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

b) Pas fjalëve “ndodhet karriera” shtohen fjalët “ose subjekti, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare”.

#### Neni 13

Në nenin 23 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në titull, pas fjalës “vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

2. Në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “qëllime publike vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

b) Pas fjalëve “nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore” shtohen fjalët “ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare”.

c) Në fund të pikës 1, pas fjalëve “qëllime vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

3. Në pikën 2, pas fjalëve “qëllime publike vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

4. Në pikën 3, pas fjalëve “qeverisjes vendore” shtohen fjalët “ose subjekti, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare”.

5. Në pikën 4, pas fjalëve “qëllime publike vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

6. Në pikën 5 bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “qëllime publike vendore” shtohen fjalët “ose kombëtare”.

b) Pas fjalëve “sipas legjislacionit në fuqi” shtohen fjalët “ose subjekti, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare”.

#### Neni 14

Në nenin 24 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 6 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Afati i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e këtij afati, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit.”

2. Në pikën 7, fjalët “për komunitetin e zonës përkatëse” zëvendësohen me fjalët “kombëtar ose lokal”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.”



## Neni 15

Në nenin 26, në fund të pikës 6 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Afat i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e këtij afati, zotëruesi i lejes minerare e humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së kërkim - zbulim - shfrytëzimit.”.

## Neni 16

Në nenin 27 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e bimësisë dhe të peizazhit ose të pasurive të tjera, si dhe të rehabilitojë të gjitha dëmtimet në sipërfaqen e tokës, të bëra gjatë kërkim - zbulim - shfrytëzimit.”.

2. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

## Neni 17

Në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3, fjalët “për komunitetin e zonës përkatëse” zëvendësohen me fjalët “kombëtar ose lokal”.

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.”.

## Neni 18

Në nenin 29, pika 1, shkronja “ë” shfuqizohet.

## Neni 19

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve “planit të rehabilitimit” shtohen fjalët “progresiv dhe”.

b) Në fjalinë e dytë, fjala “ajo” zëvendësohet me fjalët “garancia financiare”.

c) Në fjalinë e fundit, pas fjalës “rehabilitimin” shtohen fjalët “progresiv dhe”.

2. Në pikën 2, në fjalinë e dytë, fjala “ajo” zëvendësohet me fjalët “garancia financiare”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Garancia financiare për realizimin e investimit llogaritet në vlerë monetare dhe i kthehet zotëruesit të lejes së shfrytëzimit pas realizimit të investimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Garancia depozitohet brenda 20 ditëve kalendarike pas marrjes së lejes minerare të shfrytëzimit dhe afati i vlefshmërisë së saj duhet të jetë deri në 60 ditë nga data e përfundimit të periudhës së investimeve. Vlera e saj llogaritet në 10 për qind të vlerës së investimit maksimal vjetor, që përcaktohet në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare për çdo leje minerare shfrytëzimi. Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit për lejet e shfrytëzimit vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri.”.

4. Në pikën 6, në fjalinë e parë, fjala “tërheqjes” zëvendësohet me fjalën “kthimit”.

5. Në pikën 9, në fjalinë e parë dhe në fjalinë e dytë, fjalët “çdo 6 (gjashtë) muaj” zëvendësohen me fjalët “çdo vit”.

6. Pika 11 shfuqizohet.

7. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. Vlera e garancisë financiare për realizimin e investimit për lejet e shfrytëzimit i kthehet zotëruesit të lejes në fundin e periudhës së investimeve të përcaktuara sipas programit të zhvillimit të veprimtarisë minerare, kur vlera e investimit është realizuar mbi 90 për qind dhe brenda afatit kohor të parashikuar, pas hartimit të raportit të detajuar të strukturave përgjegjëse e të miratuar nga ministria.

Kthimi i plotë i garancisë financiare të investimit bëhet kur investimi është realizuar 100 për qind dhe brenda afatit kohor të parashikuar.

Kthimi i pjesshëm i garancisë financiare të investimit bëhet kur vlera e investimit është realizuar brenda afatit dhe në nivelin mbi 90 për qind. Në këtë rast, kthimi i pjesshëm i garancisë financiare të investimit bëhet në përputhje me përqindjen e realizimit të investimit.”.

8. Pika 13 ndryshohet si më poshtë:



“13. Kur zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit ka dështuar në përmbushjen e kushteve të përcaktuara në paragrafin e parë, të pikës 12, atëherë vlera e plotë e garancisë financiare të investimit kalon në favor të shtetit.”.

Neni 20

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

**Të drejtat e zotëruesit të lejes minerare mbi pasuritë e paluajtshme fqinje**

1. Zotëruesi i lejes minerare gëzon të drejtën e servitutit ligjor të detyrueshëm të rrugës së kalimit në sipërfaqen e mbitokës së pronës fqinje me zonën e lejuar minerare, në mënyrë që të marrë masat e nevojshme për të ndërtuar hyrjen dhe galerinë përkatëse për realizimin e veprimtarisë minerare.

2. Ushtrimi i së drejtës së servitutit, të parashikuar nga pika 1, e këtij neni, bëhet në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, pra zotëruesit të lejes minerare dhe pronarit të pronës fqinje, që përcakton mënyrën e ushtrimit të servitutit, dhe kundrejt pagesës vjetore të pronarit të pronës fqinje.

3. Nëse palët e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, nuk arrijnë një marrëveshje brenda një afati 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga zotëruesi i lejes, drejtuar pronarit të pronës fqinje, zotëruesi i lejes mund t'i drejtohet gjykatës. Gjykata përcakton pagesën vjetore dhe rregullat e ushtrimit të servitutit të kalimit në sipërfaqen e mbitokës së pronës fqinje. Në rastin e lejeve minerare, që jepen sipas ligjit për koncesionet, çështja gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

4. Afati i servitutit të kalimit në sipërfaqen e mbitokës së pronës fqinje është afati i vlefshmërisë së lejes minerare dhe rruga e kalimit të prona fqinje shërbyese përcaktohet sipas parimit të dëmit më të vogël për pronën shërbyese.

5. Servituti në punimet minerare nëntokësore horizontale, që i përkasin një zone tjetër ekzistuese të lejuar minerare, krijohet vetëm me marrëveshje mes palëve.

Kur e drejta e servitutit nëntokësor është përcaktuar nga zotëruesi i lejes minerare dhe është miratuar nga struktura përgjegjëse në programin vjetor të veprimtarisë minerare, kushtet dhe tarifet

për krijimin e tij përcaktohen me udhëzim të ministrit. Në rastet e tjera, kushtet dhe tarifet përcaktohen nga palët.

Përgjegjësitë për mirëmbajtjen dhe respektimin e rregullave të sigurimit teknik në zonat nëntokësore të kalimit përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar midis palëve.

6. Ndalohet krijimi i servituteve vullnetare apo të detyrueshme, në sipërfaqen e mbitokës dhe në punimet minerare nëntokësore, horizontale apo vertikale, në zonat e rrezikshme minerare.”.

Neni 21

Në nenin 36 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 10, pas fjalës “ndotjeve” shtohen fjalët “brenda zonës së lejes dhe jashtë saj, kur ndotja vjen si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë minerare të subjektit”.

2. Pika 24 shfuqizohet.

3. Në fund të pikës 25 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në funksion të veprimtarisë së saj, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion nga subjektet zotëruese të lejeve minerare, organet e administratës tatimore e doganore dhe organet e qeverisjes vendore, si dhe të publikojë në raportin vjetor të dhëna që kanë të bëjnë me pagesat e detyrimeve fiskale, të kryera nga subjektet minerare.”.

Neni 22

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare kryhen nga ministria dhe nga strukturat përgjegjëse, në varësi të saj. Organizimi dhe funksionimi i strukturave përgjegjëse të varësisë bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Siguria dhe mbrojtja e shëndetit të punonjësve, si dhe operacionet e inspektimit - shpëtimit realizohen e monitorohen nga struktura përgjegjëse.”.

Neni 23

Në nenin 45, pika 5 ndryshohet si më poshtë:



“5. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit pranë ministrit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit. Ministri ngre njësinë e ankimit, e cila shqyrton ankimin administrativ, administron dhe shqyrton provat e njofton vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit. Ky afat mund të shtyhet nga ministria deri në 10 ditë kalendarike, në rast se çmohet kryerja e verifikimeve në vendin ku ushtrohet veprimtaria minerare dhe me kusht që të njoftohet subjekti, ndaj të cilit është vendosur masa administrative. Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse dhe vendimit të njësisë së ankimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Njësia e ankimit ngrihet dhe funksionon sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.”

## Neni 24

Në nenin 46, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit, ka të drejtën e ankimit pranë ministrit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit. Ministri ngre njësinë e ankimit, e cila shqyrton ankimin administrativ, administron e shqyrton provat dhe njofton vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit. Ky afat mund të shtyhet nga ministria deri në 10 ditë kalendarike në rast se çmohet kryerja e verifikimeve në vendin ku ushtrohet veprimtaria minerare dhe me kusht që të njoftohet subjekti, ndaj të cilit është vendosur masa administrative. Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse dhe vendimit të njësisë së ankimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Njësia e ankimit ngrihet dhe funksionon sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.”

## Neni 25

Në nenin 47, pika 1, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) konstatohet se zona e licencuar ka mbivendosje të plotë ose të pjesshme, me një leje minerare që është dhënë më parë konform legjislacionit në fuqi në atë periudhë kohore. Në

këtë rast, leja minerare, e cila është dhënë në një periudhë kohore të mëvonshme është e pavlefshme për zonën e mbivendosur dhe ministri e revokon atë vetëm për zonën e mbivendosur.”.

2. Pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje:

“j) Në rast se zotëruesi i lejes minerare shkel kërkesat e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 18.”.

## Neni 26

Në nenin 48, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Ministri, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse, njofton zotëruesin e lejes minerare, duke specifikuar qëllimin e tij për të revokuar lejen minerare dhe arsyen e një veprimi të tillë. Njoftimi konsiderohet se është bërë, në rast se kanë kaluar 10 ditë kalendarike nga data e dërgimit me postë, në adresën që zotëruesi ka deklaruar në përmbajtjen e lejes minerare dhe nëse është publikuar në faqen zyrtare të ministrisë.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

3. Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit.”.

## Neni 27

Në nenin 57 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ndryshimi i koordinatave në lejen minerare lejohet në raste të veçanta, për lejet ekzistuese, të dhëna në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, “Ligji minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar, kufijtë e të cilave janë dhënë në hapësirë me 3 koordinata, sipas kushteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.





3. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Zotëruesit e lejeve minerare, që shfrytëzojnë zonën dhe trupin mineral nëpërmjet galerive nëntokësore të zotëruesve të tjerë të lejeve minerare, duhet të marrin masa që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të lidhin marrëveshjen, sipas nenit 35 të ligjit, ose të realizojnë hapjen e galerive të tyre.

5. Në zbatim të shkronjës “a/1”, të pikës 1, të nenit 47, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministria dhe strukturat përgjegjëse në varësi të saj identifikojnë rastet e mbivendosjeve të lejeve minerare dhe marrin masa për revokimin e lejeve që mbivendosen me leje minerare të dhëna më parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi në atë periudhë kohore.”.

Neni 28

#### Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3, pika 1, dhe nenit 22, pika 2, të tij.

2. Ngarkohet ministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 9, pika 2, nenit 20, pika 5, dhe neneve 23 e 24 të tij.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.10.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8758, datë 24.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

### LIGJ

Nr. 135/2014

#### PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR KUADRIN INSTITUCIONAL TË INICIATIVËS PËR GATISHMËRINË DHE PARANDALIMIN E KATASTROFAVE PËR EUROPËN JUGLINDORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit për kuadrin institucional të Inicativës për Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave për Europën Juglindore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.10.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8759, datë 24.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

#### MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MBI KUADRIN INSTITUCIONAL TË INICIATIVËS MBI GATISHMËRINË DHE PARANDALIMIN E KATASTROFAVE PËR EVROPËN JUGLINDORE

Parathënie

Qeveritë e: Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Malit të Zi, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Turqisë, që më tutje referohen si “Palët të Inicativës mbi Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave” për Evropën Juglindore (më tej si Palët e DPPI SEE):

-duke njohur nevojën për të zgjeruar më tej bashkëpunimin dhe konsultimin rajonal në fushën e menaxhimit të fatkeqësive (ndërtimit të kapaciteteve, metodave dhe praktikave) si thelbësore;

- duke riafirmuar angazhimet e tyre të shprehura në Memorandumin e Mirëkuptimit mbi Kuadrin Institucional të Inicativës mbi Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave për Evropën Juglindore, i nënshkruar nga qeveritë e Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Malit të Zi, Republikës së Rumanisë dhe Republikës së Sllovenisë në



Zagreb më 24 shtator 2007, kurse nga qeveritë e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikës së Turqisë në Sofje më 8 prill 2008 dhe nga Republika e Serbisë në Sarajevë, më 7 prill 2009;

- duke pranuar bashkëpunimin e suksesshëm midis Palëve të Iniciativës mbi Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave për Evropën Juglindore si një kuadër institucional me zotërim rajonal për Evropën Juglindore, me synim përmirësimin dhe forcimin e aftësive dhe kapaciteteve parandaluese dhe përgatitjen për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të shkaktuara nga dora e njeriut,

kanë rënë dakord si më poshtë:

## I. DPPI SEE QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

### Neni 1

Objektivat kryesorë të Iniciativës mbi Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave për Evropën Juglindore janë të kontribuojë për ngritjen e kapaciteteve institucionale të organizatave të menaxhimit të fatkeqësive për të përmirësuar parandalimin e katastrofave dhe gatishmërinë në vendet e rajonit të Evropës Juglindore (më poshtë referuar si SEE):

a) Të shërbejnë si një rrjet rajonal dhe lehtësues në gatishmërinë ndaj katastrofave dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të bëra nga njeriu në rajonin e SEE-së;

b) Të rrisë bashkëpunimin midis palëve të DPPI SEE në funksion të zgjerimit të BE-së dhe procesin e integritimit euro-atlantik;

c) Të mbështesë vendet në rajonin e SEE-së në përpjekjet e tyre për të zhvilluar më tej qasje të përbashkët në rajonin e SEE-së për gatishmërinë dhe parandalimin, përmes qasjes së përbashkët dhe bashkëpunimit me të gjitha organizatat relevante ndërkombëtare dhe organeve, sidomos Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së;

d) Të forcojë dhe rrisë bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh, për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit në fushën e gatishmërisë ndaj fatkeqësive dhe parandalimit në të gjitha nivelet ndërmjet autoriteteve kompetente kombëtare të menaxhimit të fatkeqësive dhe institucioneve të tjera relevante në rajonin e SEE-së, në përputhje me rregulloret kombëtare në lidhje me shkëmbimin e informacionit;

e) Të identifikojë dhe shkëmbejë mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira.

## II. DPPI SEE STRUKTURA E QEVERISJES DHE KOORDINIMIT

### Neni 2

### DPPI SEE, takimet rajonale

Takimi rajonal i DPPI SEE-së është një forum/organ qeverisjeje dhe vendim-marrjeje i përbërë nga shefat e autoriteteve të menaxhimit të fatkeqësive të palëve të DPPI SEE-së dhe i mbështetur nga autoritetet e tjera relevante/ministritë përgjegjëse për përgatitjen për raste fatkeqësish, parandalimin dhe çështjet e menaxhimit.

Takimi rajonal i DPPI SEE-së siguron një kornizë të politikave për DPPI SEE dhe shërben si një platformë për konsultime të brendshme dhe rekomandime për t'ua përcjellë autoriteteve të duhura kombëtare për të lehtësuar procesin e vendim-marrjes brenda qeverive kombëtare.

Ajo nxit krijimin e rrjeteve dhe bashkëpunimit me partnerë dhe aktorë ndërkombëtarë, shkëmbimin e informatave, përvojave, mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira në fushën e gatishmërisë ndaj fatkeqësive, parandalimit dhe reagimit dhe zgjidh çështjet me interes të përbashkët.

Takimi rajonal i DPPI SEE-së do të ndiqet nga palët e DPPI SEE-së. Me ftesë të Bordit Konsultativ të DPPI SEE-së, anëtarët dhe partnerët e DPPI SEE-së mund të marrin pjesë në takimin rajonal të DPPI SEE-së.

Kryesia e takimit rajonal të DPPI SEE-së do të qarkullojë në bazë vjetore ndërmjet palëve të DPPI SEE në rend alfabetik.

Takimi rajonal i DPPI SEE-së vendos me konsensus si më poshtë vijon:

a) ndryshimet në memorandumun e mirë-kuptimit;

b) vendet dhe përbërjen e sekretariatit të DPPI SEE-së;

c) çdo kërkesë në pajtim me nenin 13 të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit;

d) miratimin e rregullores mbi procedurat dhe rregullat e menaxhimit financiar;

e) miratimin e planit vjetor të punës dhe buxhetit;



f) miratimi i raportit për zbatimin e planit vjetor të punës dhe raportin vjetor financiar;

g) projektet që financohen nga buxheti DPPI SEE.

Takimi rajonal i DPPI SEE mbledhet dy herë në vit. Sesionet e jashtëzakonshme mund të planifikohen me iniciativën e kryesuesit të zyrës së DPPI SEE-së dhe me konsensusin e të gjitha palëve të DPPI SEE-së.

Takimi rajonal i DPPI SEE miraton rregullat e procedurave dhe rregulloreve të tjera të brendshme që rregullojnë punën e organeve dhe strukturave të DPPI SEE duke përfshirë dhe sekretariatit e DPPI SEE.

Neni 3

### **Bordi Këshillimor i DPPI SEE (DPPI SEE AB)**

Bordi Këshillimor i DPPI SEE përbëhet nga ekspertë me ekspertizë funksionale që përfaqësojnë partnerët ndërkombëtarë të DPPI SEE dhe ftohen nga kryesuesi i DPPI SEE. BK i DPPI SEE këshillon mbi projektet dhe aktivitetet e propozuara dhe të planifikuara, dhe kontribuon në zbatueshmërinë e politikës së ndjekur.

Nuk ka të drejta votimi formale, vendimet duhet të merren me konsensus.

Neni 4

### **Grupet e Punës të DPPI SEE (DPPI SEE WG)**

Takimi rajonal i DPPI SEE-së mund të krijojë grupe pune si struktura teknike për të zhvilluar dhe mbështetur projektet specifike të DPPI SEE. Grupet e punës së DPPI SEE do të drejtohen në baza joformale nga një vend në rajonin e Evropës Juglindore me pjesëmarrjen e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Grupet e punës së DPPI SEE raportojnë për takimin rajonal të DPPI SEE dhe janë të mbështetura nga sekretariati i DPPI SEE-së.

Neni 5

### **Mekanizmi trio**

Mekanizmi Trio (në tekstin e mëtejme “Trio”) është i përbërë nga kryesuesi aktual i DPPI SEE dhe përfaqësuesit e mëparshëm dhe hyrës të DPPI SEE.

Roli i Trio do të jetë për të siguruar koordinimin strategjik dhe planifikimin e aktiviteteve të DPPI SEE-së.

Takimet Trio do të mbahen dy herë në vit për të vijuar me takimet rajonale. Kryesuesi aktual i DPPI SEE-së në koordinim me dy anëtarët e tjerë të Trio, vendosin vendin, datën dhe rendin e ditës për takimin.

Neni 6

### **Partnerët dhe/ose donatorët e DPPI SEE**

Vendet e interesuara dhe organizatat / institucionet ndërkombëtare mund të bëhen partnerë dhe /ose donatorë të DPPI SEE-së dhe të marrin pjesë në aktivitetet e DPPI SEE-së duke njoftuar kryesuesin e DPPI SEE-së ose kreun e sekretariatit të DPPI SEE-së ose duke shprehur interesin e tillë në takimin rajonal të DPPI SEE-së.

Pjesëmarrja do të jetë me shpenzimet e vetë partnerit dhe me burimet e veta financiare dhe njerëzore.

## **III. ADMINISTRIMI I DPPI SEE SEKRETARIATI I DPPI SEE**

Neni 7

### **Vendndodhja**

Selia e sekretariatit të DPPI SEE-së është në Sarajevë, Bosnje Hercegovinë (në tekstin e mëtejme: “Vendi pritës”). Sekretariati i DPPI SEE-së duhet të ketë kapacitet ligjor të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të veta.

Vendi pritës do të ofrojë lehtësira dhe kosto operative për sekretariatit e DPPI SEE-së nëse nuk është rënë dakord ndryshe. Kapaciteti ligjor, privilegjet dhe imunitetet e sekretariatit të DPPI SEE-së do të përcaktohen në marrëveshjen e vendit pritës për t’u lidhur ndërmjet vendit pritës dhe palëve të DPPI SEE-së.

Selia e sekretariatit të DPPI SEE mund të ndryshohet me vendim konsensual të takimit rajonal të DPPI SEE-së.

Neni 8

### **Struktura dhe funksionet**

Struktura administrative/mbështetëse e DPPI SEE-së dhe SEE-CiO-së është sekretariati i DPPI SEE-së.

Sekretariati i DPPI SEE-së përbëhet nga kryesuesi i Sekretariatit të DPPI SEE dhe asistenti administrativ/financiar. Mandati i stafit të Sekretarit të DPPI SEE do të jetë katër vjet me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera.



#### Neni 9 Raportimi

Sekretariati i DPPI SEE-së punon nën drejtimin e kryesuesit të DPPI SEE-së dhe raporton tek takimi rajonal i DPPI SEE-së mbi aktivitetet e saj dhe shpenzimet. Raportim shtesë (narrativ dhe financiar) mund të kërkohej nga kryesuesi i DPPI SEE-së.

Çdo raportim do të jepet në përputhje me rregullat e procedurës dhe rregullave të menaxhimit financiar.

#### IV. BUXHETI DHE FINANCIMI I DPPI SEE

##### Neni 10 Buxheti

Buxheti i DPPI SEE-së përbëhet nga kontributet vjetore nga palët e DPPI SEE-së.

Sekretariati i DPPI SEE-së përgatit, në bazë të planit vjetor të punës së DPPI SEE, buxhetin që do të paraqitet për miratim në Takimi rajonal të DPPI SEE gjatë sesionit të vjeshtës. Sekretariati i DPPI SEE përgatit, gjithashtu plane pune shtesë dhe buxhete për projekte, të cilat mund të zbatohen me ndihmën e partnerëve të DPPI SEE-së.

Partnerët e DPPI SEE-së që kontribuojnë në buxhetin e projekteve të DPPI SEE-së mund të kërkojnë raporte specifike të auditimit.

##### Neni 11 Financimi

Aktivitetet e DPPI SEE-së do të financohen nga buxheti i DPPI SEE-së dhe mund të financohen shtesë nga partneret/donorët e DPPI SEE-së.

Palët e DPPI SEE-së bien dakord të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar burimet njerëzore, teknike dhe financiare të nevojshme për funksionimin e qëndrueshëm të kryesisë së DPPI SEE-së dhe sekretariatit të DPPI SEE-së.

Çdo palë e DPPI SEE-së në kontributet vjetore financiare për DPPI SEE-së duhet të ketë së paku € 25,000.00 dhe ato do të transferohen para përfundimit të muajit prill të çdo viti.

Vonesa në pagesën e kontributit vjetor nga një palë e DPPI SEE-së do të rezultojë menjëherë në pezullimin e të drejtës për të marrë vendime dhe

përballimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në çdo aktivitet që mbulohet nga buxheti i DPPI SEE-së deri në kohën kur pagesa është bërë.

Partitë pjesëmarrëse në DPPI SEE-së në çdo projekt të dhënë, bien gjithashtu dakord për të dhënë kontributin korrespondues të ndihmës financiare të ofruara nga partnerët DPPI SEE, subjekt i marrëveshjes reciproke, për zhvillimin dhe implementimin e projekteve.

Menaxhimi financiar i Buxhetit dhe raportimi do të jetë në përputhje me Rregullat e menaxhimit financiar të miratuara nga takimi rajonal i DPPI SEE”.

#### V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

##### Neni 12 Amendimet

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me shkrim, me pëlqimin e palëve të DPPI SEE-së. Amendamentet do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 15 të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

##### Neni 13 Pranimi

Takimi rajonal i DPPI SEE do të vendosë me konsensus mbi kërkesën e çdo pale për të aderuar në këtë Memorandum të Mirëkuptimit dhe të bëhet pjesë e DPPI SEE-së.

##### Neni 14 Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason muajin e marrjes së njoftimit të gjashtë të palëve të DPPI SEE-së, nga Ministria e Punëve të Jashtme të Bosnjë Hercegovinës në lidhje me plotësimin e kërkesave të tyre të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

Për çdo palë të DPPI SEE-së e cila pas depozitimit të njoftimit të gjashtë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bosnjë Hercegovinës në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme për hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, ai do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të tij te depozituesi.

Pas nënshkrimit, origjinali i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të depozitohet pranë Këshillit



të Ministrave të Bosnjë Hercegovinës që do të shërbejë si Depozitues. Depozituesi duhet t'u sigurojë palëve DPPI SEE të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Sekretariatit kopjet e vërtetuara në mënyrë të rregullt të tyre.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit të tij përveç nëse një palë e DPPI SEE-së deklaron në momentin e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit që kërkesat e saj të brendshme ligjore nuk lejojnë zbatimin e përkohshëm të tillë. Për çdo palë të DPPI SEE-së, Memorandumi i Mirëkuptimit do të zbatohet që nga data e përfundimit të kërkesave përkatëse të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

Neni 15  
**Kohëzgjatja**

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar, nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet palëve të DPPI SEE.

Çdo palë e DPPI SEE mund ta denoncojë këtë Memorandum të Mirëkuptimit me njoftim me shkrim drejtuar kryesuesit të DPPI SEE-së. Denoncimi do të ketë efekt tre (3) muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

Në dëshmi të dhënë këtu, nënshkruesit të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Memorandum të Mirëkuptimit.

**LIGJ**  
**Nr. 136/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË BOSNJË -  
HERCEGOVINËS PËR MBROJTJEN E  
NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË  
KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.10.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8760, datë 24.10.2014  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS  
DHE HERCEGOVINËS MBI MBROJTJEN  
RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË  
KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës (më poshtë quhen “palët”),

*Duke qenë* të ndërgjegjshëm për ndryshimet në situatën politike në botë dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për stabilizimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit reciprok;

*Duke njohur* që bashkëpunimi i mirë kërkon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve;

*Duke njohur* nevojën për vendosjen e rregullave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer brenda sferës së bashkëpunimit politik, ushtarak, ekonomik, ligjor, shkencor dhe teknologjik apo tjetër, si dhe informacionit të klasifikuar që del në procesin e këtij bashkëpunimi;

*Me synim* sigurimin e mbrojtjes reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar, që është klasifikuar nga një palë dhe transferuar palës tjetër;

*Me dëshirën* për të vendosur rregulla për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, që do të shtrihet tek të gjitha marrëveshjet mbi



bashkëpunimin që do të lidhen ndërmjet Palëve dhe kontratat që do të jepen ndërmjet organizatave të palëve, që parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

##### **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” do të thotë çdo informacion, pavarësisht formës, i cili transferohet ose gjenerohet ndërmjet palëve sipas ligjeve dhe rregulloret të brendshme të një pale dhe që në interes të sigurisë kombëtare kërkon mbrojtje kundrejt deklarimit të paautorizuar ose një kompromentimi tjetër dhe destinohet si i tillë dhe shënjohet rregullisht nga një palë.

2. “Pala marrëse” pala, duke përfshirë çdo subjekt publik ose privat në juridiksionin e saj, që merr informacion të klasifikuar nga pala e origjinës.

3. “Pala e origjinës” pala, duke përfshirë çdo subjekt publik ose privat në juridiksionin e saj, që i jep informacion të klasifikuar palës marrëse.

4. “Pala e tretë” është një organizatë ndër-kombëtare ose një shtet i tretë që nuk është një palë në këtë marrëveshje.

5. “Autoritet kompetent i sigurisë” është autoriteti kryesor i cili, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, është përgjegjës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje të palës përkatëse.

Këto autoritete janë renditur në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje.

6. “Parimi “Nevojë për njohje” është domosdoshmëria për të patur akses në informacionin e klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare dhe/ose përmbushjen e një detyre zyrtare konkrete.

7. “Kontraktor” është një subjekt fizik ose juridik që ka zotësinë juridike për të lidhur kontrata të klasifikuara.

8. “Kontratë e klasifikuar” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve shtetërore ose subjekteve juridike që krijojnë ose përcaktojnë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre që përmbajnë ose përfshijnë informacion të klasifikuar.

9. “Vizitorë” janë përfaqësues zyrtarë të një pale që kërkojnë të vizitojnë objektet dhe mjediset e palës tjetër të përfshirë në aktivitete që kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar.

10. “Certifikatë sigurie personeli” do të thotë dokumenti i dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë për një shtetas të një pale për akses tek informacioni i klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme.

11. “Certifikatë sigurie industriale” do të thotë dokumenti i dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë që provon që një shoqëri/strukturë është me leje sigurie për akses në informacionin e klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme.

12. “Shkelje e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, që rezulton ose mund të rezultojë në akses të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

#### Neni 2

##### **Zbatueshmëria**

Kjo marrëveshje përfshin të gjitha aktivitetet, në kuadrin e të cilëve gjenerohet ose shkëmbet informacion i klasifikuar ndërmjet palëve ose një individ apo një subjekti juridik nën juridiksionin e shteteve të tyre me qëllim që të përmbushin detyrat e tyre publike.

#### Neni 3

##### **Nivelet e klasifikimit të sigurisë**

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të sigurisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë së specifikuar në ligjet dhe rregulloret e brendshme të palës përkatëse.

Për Republikën e Shqipërisë	ekuivalenti në anglisht	Për Bosnjën dhe Hercegovinën
TEPËR SEKRET	TOP SECRET	VRLO TAJNO
SEKRET	SECRET	TAJNO
KONFIDENCIAL	CONFIDENCIAL	POVJERLJIVO
I KUFIZUAR	RESTRICTED	INTERNO

#### Neni 4

##### **Autoritetet kompetente të sigurisë**

1. Autoritetet kompetente të sigurisë së palëve janë sa më poshtë:

- Për Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

- Për Bosnjën dhe Hercegovinën:

Ministarstvo sigurnosti Bosne i Hercegovine (Ministria e Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës)  
Sektor za zastitu tajnih podataka-Drzavni



sigurnosni organ (Sektori për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar – Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

2. Autoritetet kompetente të sigurisë njoftojnë njëri-tjetrin për ligjet dhe rregulloret e brendshme në fuqi që rregullon mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim i ngushtë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente të sigurisë mund të zhvillojnë konsultime me kërkesën e bërë nga një prej tyre.

4. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standardet e krahasueshme të sigurisë, autoritetet përkatëse kompetente të sigurisë, me kërkesë, i japin njëri-tjetrit informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikën e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të zbatuara nga pala përkatëse.

5. Palët njohin certifikatat e sigurisë së personelit dhe industriale, të lëshuara nga autoritetet kompetente të sigurisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

#### Neni 5

### Parimet e sigurisë

1. Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, palët zbatojnë të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, që gjenerohet ose shkëmbehet zakonisht sipas kësaj marrëveshjeje. I njëjti nivel mbrojtjeje sigurohet për këtë informacion të klasifikuar, siç parashikohet për informacionin e klasifikuar të brendshëm, me nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë.

2. Palët njoftojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur në lidhje me ndryshimet në ligjet dhe rregulloret e brendshme që ndikojnë në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Në këto raste, palët njoftojnë njëra-tjetrën në pajtim me nenin 4, paragrafët 3 dhe 4, të kësaj marrëveshjeje, me qëllim që të diskutojnë ndryshimet e mundshme të kësaj marrëveshjeje. Ndërkohë, informacioni i klasifikuar mbrohet në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

3. Aksesit në informacion e klasifikuar kufizohet tek ata persona që kanë nevojë për njohje, pasi të kenë marrë certifikatën e sigurisë nga autoriteti kompetent i sigurisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, në përputhje me nivelin e

kërkuar të klasifikimit të sigurisë së informacionit i cili aksesohet.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë me kërkesë, ndihmojnë njëri-tjetrin në zbatimin e procedurave për certifikatat e sigurisë.

5. Pala pritëse është e detyruar:

a) të mos i japë informacion të klasifikuar një pale të tretë pa aprovimin e mëparshëm me shkrim të palës së origjinës;

b) t'i vendosë informacionit të klasifikuar nivelin e klasifikimit të sigurisë të barasvlershëm me atë të parashikuar në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje dhe në vazhdimësi të sigurojë mbrojtjen e barasvlershme me atë të dhënë nga pala e origjinës;

c) të mos e përdorë informacionin e klasifikuar për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është dhënë.

6. Nëse një marrëveshje tjetër e përfunduar ndërmjet palëve përmban rregulla më rigorozë në lidhje me shkëmbimin ose mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, zbatohen këto rregullime.

#### Neni 6

### Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar transmetohet nëpërmjet shërbimeve diplomatike, ushtarake dhe të tjera korrieri, të aprovuara nga autoriteti kompetent i sigurisë. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Nëse duhet të transmetohet një paketë e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet përkatëse kompetente të sigurisë bien bashkërisht dakord dhe aprovojnë me shkrim mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për çdo rast të tillë.

3. Mjetet e tjera të aprovuara të transmetimit ose shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, duke përfshirë mjetet elektro-magnetike mund të përdoren nëse bihet dakord me shkrim, nga autoritetet kompetente të sigurisë.

#### Neni 7

### Shënimi i informacionit të klasifikuar

1. Pala pritëse shënjon informacionin e klasifikuar, me shënjinin përkatës të klasifikimit në pajtim me nenin 3.

2. Kopjet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë shënjohehen dhe trajtohen në të njëjtën mënyrë si dhe origjinalet.



3. Kërkesat për shënjim zbatohen gjithashtu për informacionin e klasifikuar të gjeneruar në lidhje me një kontratë të klasifikuar.

#### Neni 8

### Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i shënjuar me një nivel të klasifikimit të sigurisë TEPËR SEKRET/TOP SECRET/VRLO lejohet për përkthim dhe kopjim vetëm me lejen me shkrim, të autoritetit kompetent të sigurisë, së palës së origjinës.

2. Të gjitha kopjet e riprodhuara të informacionit të klasifikuar, shënjohen me të njëjtin shënjim si origjinali. Ky informacion i riprodhuar vendoset në të njëjtin kontroll si dhe informacioni origjinal. Numri i kopjeve kufizohet tek ai që kërkohet për qëllime zyrtare.

3. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar, bëhen nga individë me certifikatë sigurie. Përkthimi shënjohet me shënjimin e klasifikimit origjinal dhe mban një shënim të përshtatshëm në gjuhën në të cilën është përkthyer, që përkthimi përmban informacion të klasifikuar të palës së origjinës.

#### Neni 9

### Asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar asgjësohet deri në atë masë sa të mënjanohet rindërtimi i tij i plotë ose i pjesshëm.

2. Informacioni i klasifikuar me nivel klasifikimi sigurie si TEPËR SEKRET/TOP SECRET/VRLO nuk asgjësohet. Ai i kthehet autoritetit përkatës kompetent të sigurisë, së palës së origjinës.

3. Pala e origjinës, me anë të shënjimit shtesë ose dërgimit të njoftimit pasues me shkrim, mund të ndalojë shprehimisht riprodhimin, ndryshimin ose asgjësimin e informacionit të klasifikuar. Nëse ndalohet asgjësimi i informacionit të klasifikuar, ai i kthehet palës së origjinës.

4. Në rastin e një situatë krize, informacioni i klasifikuar, i cili është i pamundur të mbrohet ose t'i kthehet palës së origjinës, asgjësohet menjëherë. Pala pritëse njofton me shkrim palën e origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

#### Neni 10

### Kontratat e klasifikuara

1. Kontratat e klasifikuara lidhen dhe zbatohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të secilës palë. Me kërkesë autoriteti kompetent i sigurisë i secilës palë jep konfirmimin që një kontraktues i propozuar është pajisur me një certifikatë të përshtatshme kombëtare sigurie industriale, sipas nivelit të kërkuar për klasifikimin e sigurisë. Nëse kontraktori i propozuar nuk e ka një certifikatë të përshtatshme sigurie industriale, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës palë mund të kërkojë që ai kontraktor të marrë leje sigurie.

2. Një klauzolë sigurie do të jetë pjesë integrale e çdo kontrate të klasifikuar ose nënkontrate, nëpërmjet të cilës kontraktori i palës së origjinës specifikon se cili informacion i klasifikuar do t'i jepet ose gjenerohet nga pala pritëse dhe cili nivel përkatës i klasifikimit të sigurisë i është caktuar këtij informacioni.

3. Detyrimet e kontraktorit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas një kontrate të klasifikuar u referohen, të paktën, sa më poshtë:

a) deklarimi i informacionit të klasifikuar ekskluzivisht personave që janë pajisur paraprakisht me certifikatën e përshtatshme të sigurisë së personelit, të cilët kanë nevojë për njohje dhe që janë punësuar ose përfshirë në përmbushjen e kontratës;

b) transferimi i informacionit të klasifikuar me mjete sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje;

c) procedurat dhe mekanizmat e komunikimit të ndryshimeve që mund të lindin në lidhje me informacionin e klasifikuar për shkak të ndryshimeve në nivelin e klasifikimit të sigurisë ose në rastin e deklasifikimit;

d) një detyrim për të njoftuar në kohën e duhur autoritetin kompetent të sigurisë së kontraktorit për një akses faktik, në tentativë, të dyshuar ose të paautorizuar në informacionin e klasifikuar të kontratës;

e) përdorimi i informacionit të klasifikuar sipas kontratës vetëm për qëllimet në lidhje me objektin e kontratës;

f) respektimi rigoroz i dispozitave të kësaj marrëveshjeje në lidhje me procedurat për asgjësimin e informacionit të klasifikuar;

g) dhënien e informacionit sipas një kontrate të klasifikuar, një pale të tretë, vetëm me





pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

4. Masat e kërkuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedura për vlerësimin dhe zhvendësimin për humbje të mundshme të shkaktuara kontraktorëve, nga aksesit i paautorizuar në informacionin e klasifikuar, specifikohet në më shumë hollësi në kontratën e klasifikuar përkatëse.

5. Kontrata e klasifikuar me nivel klasifikimi sigurie I KUFIZUAR / RESTRICTED / INTERNO përmban një klauzolë të përshtatshme të sigurisë që identifikon masat minimale për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Nuk kërkohet certifikatë sigurie industriale për këto kontrata.

6. Nënkontraktorët u nënshtrohen të njëjtave kërkesa të sigurisë si kontraktori që ka lidhur kontratën kryesore të klasifikuar.

#### Neni 11 Vizitat

1. Ekspertët e sigurisë, të autoriteteve kompetente të sigurisë, mund të mbajnë konsultime të rregullta për të diskutuar për procedurën e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.

2. Autoriteti kompetent i sigurisë së palës pritëse, lëshon autorizim paraprak për vizitë për të gjithë vizitorët, të cilët kanë certifikatë të përshtatshme sigurie personeli, nëse atyre u duhet akses në informacionin e klasifikuar ose në mjediset ku ka origjinën, trajtohet ose ruhet informacioni i klasifikuar.

3. Për procedurat e vizitave bihet dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë së palëve.

4. Kërkesa për vizitë paraqitet nëpërmjet autoritetit kompetent të sigurisë, të paktën dymbëdhjetë ditë para vizitës dhe përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës ose një numër tjetër të një karte identiteti;
- b) kombësinë/shtetësinë e vizitorit;
- c) emërtesën e pozicionit të vizitorit dhe emrin e organizatës që përfaqëson;
- d) certifikatën e sigurisë së personelit, të vizitorit me nivelin e përshtatshëm të klasifikimit;

e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;

f) emrin e organizatave dhe strukturave që kërkohen të vizitohen;

g) datën, nënshkrimin dhe vulën e autoritetit dërgues kompetent të sigurisë.

5. Në raste urgjente, autoritetet kompetente të sigurisë, mund të bien dakord për një periudhë më të shkurtër për paraqitjen e një kërkesë për një vizitë.

6. Autoritetet kompetente të sigurisë së palëve, aprovojnë listën e vizitorëve që mund të përsërisin vizitat brenda dymbëdhjetë muajve, për qëllimin e përmbushjes së një kontrate të klasifikuar. Kushtet e vizitave specifike përcaktohen drejtpërdrejt me autoritetet përkatëse të kontraktorëve.

7. Secila palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të brendshme.

#### Neni 12 Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e shkeljes së sigurisë, autoriteti kompetent i sigurisë, në shtetin e të cilit ka ndodhur shkelja e sigurisë, njofton autoritetin kompetent të sigurisë së palës tjetër, në kohën e duhur dhe siguron hetim të përshtatshëm. Nëse kërkohet, pala tjetër bashkëpunon në hetim.

2. Në rast se shkelja e sigurisë ndodh në një palë të tretë, autoriteti kompetent i sigurisë i palës së origjinës ndërmer të gjitha veprimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, sipas rastit.

3. Pala tjetër njoftohet për rezultatet e hetimit dhe merr një deklaram përfundimtar në lidhje me shkaqet e ngjarjes dhe masën e dëmit.

#### Neni 13 Shpenzimet

Secila palë mbulon shpenzimet e veta të bëra gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 14 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe negociata ndërmjet palëve dhe nuk i paraqitet asnjë tribunali ndërkombëtar apo një palë të tretë.



Neni 15  
**Dispozita të fundit**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit palët kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike që kërkesat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta denoncojë këtë marrëveshje duke i bërë palës tjetër njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje prishet gjashtë (muaj) nga data në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.

4. Në rastin e prishjes së kësaj marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i transferuar në pajtim me këtë marrëveshje vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në të.

Bërë në.....më.....në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, gjuhët zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës (gjuhën boshnjake, kroate, serbe) dhe gjuhën angleze ku të gjitha tekstet janë njëloj të vlefshëm. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës  
së Shqipërisë  
**Arben Seferi**

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës  
dhe Hercegovinës

**VENDIM**  
**Nr. 78/2014**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT  
PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT  
HETIMOR “PËR SHQYRTIMIN E  
KËRKESËS SË NJË GRUPI  
DEPUTETËSH ME OBJEKT  
“SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË  
KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË,  
TË ZGJEDHUR NGA KUVENDI, Z.  
ELVIS ÇEFA DHE Z. LULZIM LELÇAJ,  
PËR SHKELJE TË RËNDË TË LIGJIT”,  
NGRITUR ME VENDIMIN E  
KUVENDIT NR. 70/2014**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 114, pika 3, të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratimin e Raportit Përfundimtar, të konkluzioneve dhe të rekomandimeve të Komisionit Hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh me objekt “Shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj, për shkelje të rëndë të ligjit””.

II. Dërgimin në Këshillin e Lartë të Drejtësisë të Raportit Përfundimtar për t’u njohur me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 23.10.2014



**VENDIM**  
**Nr. 79/2014**

**PËR SHKARKIMIN E ANËTARIT TË**  
**KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË,**  
**TË ZGJEDHUR NGA KUVENDI,**  
**Z. ELVIS ÇEFA**

Në mbështetje të neneve 4, 78 dhe 147 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 3, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 114, pika 3, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Shkarkimin nga detyra për shkelje të Kushtetutës dhe shkelje të rënda të ligjit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 23.10.2014

**VENDIM**  
**Nr. 80/2014**

**PËR SHKARKIMIN E ANËTARIT TË**  
**KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË,**  
**TË ZGJEDHUR NGA KUVENDI, Z.**  
**LULZIM LELÇAJ**

Në mbështetje të neneve 4, 78 dhe 147 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 3, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 114, pika 3, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Shkarkimin nga detyra për shkelje të Kushtetutës dhe shkelje të rënda të ligjit të anëtarit

të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Lulzim Lelçaj.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 23.10.2014

**VENDIM**  
**Nr. 81/2014**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË**  
**GRUPI DEPUTETËSH “PËR NGRITJEN**  
**E NJË KOMISIONI HETIMOR PËR TË**  
**KONTROLLUAR ZBATIMIN E**  
**LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR**  
**ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË**  
**DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE,**  
**SI DHE PËR TË NJOHUR DHE**  
**VERIFIKUAR NË THELLËSI**  
**FENOMENIN E NDËRHYRJES DHE**  
**BLOKIMIT PËR DISA DITË TË**  
**SISTEMEVE ELEKTRONIKE**  
**TATIMORE”**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në zbatim të vendimit nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Partisë Demokratike “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”.

II. Komisioni ka si qëllim të veprimtarisë së tij: Mbledhjen e informacioneve të hollësishme mbi zbatimin e legjislacionit në fuqi nga ana e administratës tatimore dhe arsyeve të mosfunksionimit të sistemeve të tatimeve për disa ditë, duke evidentuar problematikat përkatëse dhe për të gjetur zgjidhjet për të



ardhmen, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve, nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, nevojën e ndryshimeve apo miratimeve ligjore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

III. Objekt i veprimtarisë së komisionit është “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”.

IV. Komisioni hetimor përbëhet nga 11 anëtarë, 6 anëtarë nga shumica parlamentare dhe 5 anëtarë nga opozita. Kryetari i komisionit i takon grupit të deputetëve nismëtarë dhe zëvendëskryetari i takon shumicës parlamentare. Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në një afat prej 2 (dy) muajsh nga data e miratimit të tij.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij komisioni hetimor.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 23.10.2014

**VENDIM**  
**Nr. 82/2014**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT**  
**HETIMOR TË KUVENDIT PËR**  
**VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË**  
**EMËRIMEVE NË DETYRË NË**  
**ADMINISTRATËN SHTETËRORE,**  
**ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË**  
**TREGTARE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit“, dhe nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në zbatim të vendimit nr. 30, datë 16.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Ngrihet komisioni hetimor parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Partisë Demokratike “Për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë, të realizuara gjatë periudhës 15 shtator 2013 - 31 maj 2014 në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore”.

II. Komisioni ka si qëllim që, nëpërmjet verifikimit të ligjshmërisë së emërimeve në detyrë, të realizuara gjatë periudhës 15 shtator 2013 - 31 maj 2014 në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, të evidentojë problematikat përkatëse dhe të japë rekomandime, të nxjerrë përgjegjësitë institucionale, nevojën e ndryshimeve apo miratimeve ligjore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave ligjore.

III. Objekt i veprimtarisë së komisionit është “Verifikimi ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore”.

Nuk mund të jenë objekt i veprimtarisë së këtij komisioni, çështje, për të cilat gjykata është shprehur me një vendim të formës së prerë, apo çështje të cilat janë në proces gjykimi.

IV. Komisioni hetimor përbëhet nga 9 anëtarë, 5 anëtarë nga shumica parlamentare dhe 4 anëtarë nga opozita. Kryetari i komisionit i takon grupit të deputetëve nismëtarë dhe zëvendëskryetari i takon shumicës parlamentare. Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në një afat prej 2 (dy) muajsh nga data e miratimit të tij.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij komisioni hetimor.

VII. Me miratimin e këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 40/2014 i Kuvendit.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 23.10.2014



## VENDIM

Nr. 15, datë 10.10.2014

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT  
PËR PROJEKTET NË VAZHDIM PËR  
ARSIMIN, VADITJEN DHE KULLIMIN,  
ARTIN DHE KULTURËN,  
INFRASTRUKTURA VENDORE, PJESË  
E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E  
RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

## VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për financimin e mbetur, të papërdorur, për projektet në vazhdim (të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve gjatë viteve 2012-2013), pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas fushave përkatëse, si më poshtë vijon:

a) në fushën e ujitje - kullimit, 56 141 526 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e dyzet e një mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), 1 043 562 322 (një miliard e dyzet e tre milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e dy) lekë, specifikuar sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi, përkatësisht për:

i) arsimin bazë, 666 931 322 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e njëzet e dy) lekë;

ii) arsimin e mesëm të përgjithshëm, 251 131 000 (dyqind e pesëdhjetë e një milionë e njëqind e tridhjetë e një mijë) lekë;

iii) arsimin universitar, 125 500 000 (njëqind e njëzet e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë;

ç) në fushën e artit dhe kulturës, 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në fushën e infrastrukturës vendore, shpërndarjen e fondeve prej 1 050 804 403 (një miliard e pesëdhjetë milionë e tetëqind e katër mijë e katërqind e tre) lekë, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi, me burim financimi të përmendur në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, si më poshtë vijon:

a) fondin prej 590 000 000 (pesëqind e nëntëdhjetë milionë) lekësh, detajuar në pikën 7, të vendimit nr. 12, datë 1.8.2014;

b) pjesë nga fondi prej 2 570 000 000 (dy miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, të parashikuar në ligjin nr. 122/2014, datë 25.9.2014, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”.

3. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (në cilësinë e ish-Sekretariatit Teknik për Infrastrukturën Vendore), ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.



Tabela 1. Projektet në vazhdim për ujitjen dhe kullimin, për financim nga fondi për zhvillimin e rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontraktuar (lekë)	Vlera për financim për vitin 2014 (lekë)
<b>QARKU BERAT</b>				
1	Bashkia Skrapar	Mbrojtje nga lumi Osum, krahu u majtë i zonës Çorovodë - Munushtir	30,586,672	6,987,202
<b>QARKU DIBËR</b>				
2	Komuna Baz	Rehabilitimi i sistemit kryesor ujitës, i rezervuarit të Bazit nr.2 (rehabilitimi i kanalit U1)	29,205,046	21,379,202
<b>QARKU VLORË</b>				
3	Komuna Xarrë	Kanali ushqyes i rezervuarit të Bezhanit dhe veprat ujitëse të komunës Xarrë	23,611,032	3,935,568
<b>QARKU ELBASAN</b>				
4	Komuna Mollas	Rehabilitimi i kanaleve ujitëse sekondare në komunën Mollas	30,512,283	9,752,239
<b>QARKU KORÇË</b>				
5	Komuna Qendër Ersekë	Rikonstruksioni i kanalit ujitës të ujëmbledhësit Gjonç	17,087,315	14,087,315
<b>TOTALI</b>			<b>131,002,348</b>	<b>56,141,526</b>

## Shënim

“Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e paraqitur nga sekretariati teknik përkatës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për shlyerjen e detyrimeve për projektet në vazhdim, të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë viteve 2012-2013. Kjo vlerë përfaqëson diferencën midis vlerës së kontratës dhe vlerës së paguar të financimit deri më tani

Tabela 2. Projektet në vazhdim për arsimin, për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Programi	Emërtimi i projektit	Vlera për likuidim për 2014 (lekë)
		09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	666,931,322
1	Bashkia Përmet	09120	Shkolla 9-vjeçare “Nonda Bulka”, Bashkia Përmet (FZHR)	53,963,980
2	Bashkia Peshkopi	09120	Rikonstruksion + shtesë kati, kopshti nr. 2, Bashkia Peshkopi (FZHR)	25,784,341
3	Komuna Trebisht	09120	Përfundim i ndërtimit të shkollës 9-vjeçare Trebisht, komuna Trebisht (FZHR)	4,904,055
4	Komuna Suc	09120	Ndërtim shkollë 9-vjeçare dhe kopsht Kurdari, komuna Suc (FZHR)	16,734,320
5	Komuna Terthore	09120	Rikonstruksion shkolla 9-vjeç Pobreg, komuna Terthore (FZHR)	4,539,694
6	Komuna Surroj	09120	Ndërtim shkolla 9-vjeçare, fshati Qinamak, komuna Surroj (FZHR)	20,148,467
7	Komuna Kalis	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, fshati Kalis, komuna Kalis (FZHR)	13,437,966



8	Komuna Golaj	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare, fshati Helshan, komuna Golaj (FZHR)	20,596,299
9	Komuna Derjan	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Kuvendi i Dukagjinit”, fshati Dukagjin (FZHR)	10,358,880
10	Komuna Bushat	09120	Ndërtim kopshti dhe sistemim i ambienteve të jashtme të shkollës së mesme të bashkuar "Gjon Ndoci", komuna Bushat (FZHR)	775,772
11	Komuna Gjegjan, Puke	09120	Rikonstruksion i god.te shk.mes.bashkuar dhe amb.sportive Gjegjan, Puke (FZHR)	2,679,805
12	Komuna Polis	09120	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Polis Gurshpatë (FZHR)	1,626,842
13	Komuna Lopes	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Sinanaj, komuna Lopez, Tepelenë (FZHR)	12,270,000
14	Komuna Bucimas, Pogradec	09120	Ndërtim shkolla 9-vjeçare Verdovë, komuna Buçimas, Pogradec (FZHR)	5,655,516
15	Bashkia Orikum	09120	Rikonstruksion kopshti "Mustafa Qemal Atatürk" Orikum, Bashkia Orikum (FZHR)	1,044,735
16	Komuna Qender Vlore	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Bestrove, komuna Qendër Vlorë (FZHR)	9,046,334
17	Bashkia Tiranë	09120	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Ahmet Gashi” (FZHR)	53,620,291
18	Bashkia Tiranë	09120	Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare në zonën ish-Kombinatit Tekstil (FZHR)	25,489,000
19	Bashkia Kamez	09120	Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare Lagje nr. 4 Kamëz, Bashkia Kamëz (FZHR)	56,173,272
20	Komuna Gose	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Gosë, komuna Gosë (FZHR)	21,876,501
21	Bashkia Mamurras	09120	Rikonstruksion i shkollës nr. 2 Mamuras (FZHR)	11,672,241
22	Komuna Milot	09120	Ndërtim kopsht femijësh Milot, komuna Milot (FZHR)	13,688,313
23	Bashkia Roskovec	09120	Rikonstruksion dhe shtesë anësore shk 9-vjeç "Alush Greçka", Bashkia Roskovec (FZHR)	21,380,227
24	Komuna Kurjan	09120	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare fshati Ngjeçar, komuna Kurjan (FZHR)	11,482,000
25	Komuna Qendër Mallakastër	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare fshati Visoke, komuna Qendër, Mallakastër (FZHR)	11,112,000
26	Komuna Bubullimë	09120	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar "DH.Mino", komuna Bubullimë (FZHR)	10,880,000
27	Komuna Tërbuf	09120	Rikonstruksion dhe shtesë e shkollës së mesme të bashkuar Çermë Sektor, Tërbuf, komuna Tërbuf (FZHR)	14,057,000
28	Komuna Rrashbull	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare në fshatin Rromanat, komuna Rrashbull (FZHR)	18,756,638
29	Komuna Xhafzotaj	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare në fshatin Rreth, Komuna Xhafzotaj (FZHR)	37,794,820
30	Komuna Rrashbull	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Stacioni Zooteknik Xhafzotaj, komuna Rrashbull (FZHR)	10,475,125



31	Komuna Katund i Ri	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare fshati Sukth, komuna Katund i Ri (FZHR)	20,000,000
32	Komuna Lumas	09120	Rikonstruksion i shkollës filllore fshati Bardhaj	5,487,300
33	Bashkia Polican, Skrapar	09120	Rikonstruksion kopshti nr. 2, Poliçan (FZHR)	4,666,800
34	Komuna Shupenze	09120	Shkolla 9- vjeçare Topojan (FZHR)	4,293,606
35	Komuna Ostren	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Lejçan (FZHR)	10,495,905
36	Bashkia Sukth	09120	Rikonstruksion shkolla filllore 2kt Kull, (FZHR)	3,212,760
37	Komuna Paper	09120	Shkolla 9-vjeçare Paper Sollak ( obj i ri) (FZHR)	10,055,712
38	Komuna Porocan	09120	Shkolla 9-vjeçare vartëse Gjerë (FZHR)	3,860,275
39	Komuna Kushove	09120	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Sotirë (FZHR)	9,739,835
40	Bashkia Lushnje	09120	Rikonstruksion shkolla Savër (FZHR)	7,683,403
41	Komuna Drenove, Korçe	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Ravonik, Komuna Drenove (FZHR)	4,577,040
42	Komuna Miras, Devoll	09120	Ndërtim shkolla 9-vjeçare fshati Vidohovë, komuna Miras (FZHR)	20,029,317
43	Komuna Kalis	09120	Ndërtimi i shkollës së CU fshati Kodër-Gështenjë (FZHR)	3,035,395
44	Komuna Tropoje	09120	Rikonstruksioni i shkollës 9- vjeçare Gegaj (FZHR0	8,050,334
45	Komuna Hajmel	09120	Rikonstruksion i shkollës CU Paçram (FZHR)	587,838
46	Komuna Zallbatar	09120	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Bastar-Murriz (FZHR)	12,006,822
47	Komuna Golem	09120	Shkolla 9-vjeçare Zikxhafaj (FZHR)	6,668,570
48	Komuna Gurre	09120	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Gurrë e Vogël (FZHR0	2,369,846
49	Komuna Lekas, Korçe	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Lekas, Komuna Lekas (FZHR)	3,594,695
50	Komuna Qafë Mali	09120	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Kryezi, komuna Qafë Mali	4,491,435
		09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	255,099,859
1	Komuna Mollas	09230	Ndërtim i shkollës së mesme “Osman Gjini”, komuna Mollas, Elbasan (FZHR)	63,658,737,
2	Komuna Kashar	09230	Palest+ngroh+sistemim, shkolla e mesme Katund Ri, komuna Kashar, (FZHR)	6,466,307
3	Bashkia Krujë	09230	Rikonstruksion shkolla e mesme “Skënderbej”, Krujë (FZHR)	20,407,638





4	Komuna Ulëz	09230	Rikonstruksion i shkollës Papa Gjon Pali II (FZHR)	10,698,784
5	Komuna Skënderbegas	09230	Shkolla e mesme e bashkuar “Xhile Lici” Skënderbegas (FZHR)	7,484,520
6	Komuna Bradashesh	09230	Ndërtim shkollë e mesme Bradashesh (FZHR)	80,000,000
7	Komuna Zharrës	09230	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Sotir Capo”, fshati Zharrës (FZHR)	14,137,732
8	Komuna Radokal, Pogradec	09230	Ndërtim i ri, shkolla e mesme e bashkuar Radokal	34,687,550
9	Komuna Dajt	09230	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar, Surrel	7,431,593
10	Komuna Vranisht, Vlorë	09230	Shkolla e mesme e bashkuar e Kuçit, komuna Vranisht	10,126,998
		09450	Arsimi universitar	125,500,000
1	Qendra e Studimeve Albanologjike	09450	Rikonstruksion i korpusit kryesor, Qendra Albanologjike (detyrim)	15,500,000
2	Universiteti “A. Moisiu”, Durrës	09450	Ndërtimi i një godine të re universitare për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës (detyrim)	60,000,000
3	Universiteti Politeknik	09450	Shtesa e godinës së Universitetit Politeknik Tiranë (detyrim)	50,000,000
<b>TOTALI</b>				<b>1,073,531,181</b>

## Shënim

“Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e paraqitur nga sekretariati teknik përkatës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për shlyerjen e detyrimeve për projektet në vazhdim, të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë viteve 2012-2013. Kjo vlerë përfaqëson diferencën midis vlerës së kontratës dhe vlerës së paguar të financimit deri më tani.

Tabela 3. Projektet në vazhdim për artin-kulturën, për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera për financim në vitin 2014 (lekë)	Vlera për financim në vitin 2015 (lekë)
QARKU VLORË					
1	Komuna Markat	Varrezat monumentale të shqiptarëve të Çamërisë në Killoqer	77,000,000	25,000,000	30,103,872
<b>TOTALI</b>			<b>77,000,000</b>	<b>25,000,000</b>	<b>30,105,872</b>

Tabela 4. Projektet në vazhdim për infrastrukturën vendore, për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e kontratës (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)
1	Komuna Cepo	Urat automobilistike të poshtme dhe të sipërme në fshatin Zhulat, mbi lumin e Zhulatit	36,748,014	20,291,066
2	Komuna Krahës	Asfaltim rrugë- Rrugë nacionale - Lagjja Bregadovë - Buckaj	19,933,547	10,652,422
3	Komuna Kutë	Ndërtimi i rrugës Fratar - Drizar	26,400,000	13,502,635
4	Komuna Hoçisht	Sistemim asfaltim rruga Hoçisht-Gracë	26,991,480	16,999,660
5	Komuna Sevaster	Sistemim, asfaltim i rrugës Ploc - Amonicë, fshati Amonicë	72,348,090	41,470,649
6	Komuna Selitë	Ndërtimi i rrugës Goras-Aranitas (faza I)	29,144,583	17,144,583
7	Komuna Novoselë	Rikonstruksion i rrugës Hidrovor Akërnë (faza II)	43,940,580	21,794,942



8	Komuna Klos	Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës “Ura e lumit Devoll-Floq”	23,382,500	9,029,289
9	Komuna Xhafzotaj	Sistemim, Asfaltim i rrugëve të fshatrave Borakë dhe Koxhasë (faza I)	60,615,907	42,043,245
10	Këshilli i Qarkut Tiranë	Rikonstruksioni rrugës Pëllumbas - Killojkë	56,001,828	21,954,501
11	Komuna Lumas	Rikonstruksion i rrugës Qendër - Lumas, Shaipllar - Katundas, (seg. 1+2)	57,952,679	28,844,367
12	Komuna Cukalat	Rikonstruksion i rrugës “Donofros – Velmish”	82,231,327	35,570,475
13	Komuna Zerqan	Rruga Zerqan - Tre Çezmat (faza I)	62,411,329	25,569,492
14	Komuna Shirgjan	Rikonstruksioni i rrugës urbane Kryqëzimi i rrugës automobilistike Elbasan - Cërrik, fshati Bujgës	40,470,966	15,006,710
15	Komuna Çlirim	Rikonstruksion i rrugës Qafëzezë - Çlirim	30,225,997	10,796,819
16	Komuna Macukull	Ndërtim i Rrugës së fshatit Shelli (lidhja e fshatit Shelli me Shqefen dhe Macukull)	27,184,093	10,690,510
17	Komuna Perondi	Rikonstruksion i rrugës Magjate - Goraj - Velagosht (faza I)	51,458,800	16,697
18	Bashkia Belsh	Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve kryesore të qytetit të Belshit (faza I)	55,724,746	5,577,673
19	Komuna Macukull	Rruga Lis - Shlli	66,304,200	35,327,924
20	Komuna Komsj	Sistemim, Asfaltim i rrugës së fshatit Pjejëz	23,340,743	8,896,939
21	Këshilli i Qarkut Durrës	Rikonstruksion i rrugës Tunel i Rrashbullit - Varrezat e reja	24,557,450	9,931,324
22	Bashkia Peshkopi	Sistemim, asfaltim i rrugës poshtë gjykatës	19,869,029	1,389
23	Komuna Hudënisht	Sistemim asfaltim rruga lart fshati Memlisht	33,399,912	11,704,500
24	Komuna Ballagat	Rikonstruksioni i rrugës “Jazxhia –Ballgat” (faza I)	19,998,820	360,631
25	Komuna Lumas	Rikonstruksioni i rrugës Shqez - Vodes- Koritëz (faza I)	44,920,000	26,920,000
26	Komuna Blinisht	Asfaltim i rrugës kryesore të fshatit Fishtë (faza I)	58,732,757	38,596,398
27	Bashkia Delvinë	Rikonstruksion i rrugës Delvinë - Rusan	34,046,036	16,966,244
28	Komuna Sukë	Sistemim, asfaltim i rrugës së fshatit Podgoran	28,795,632	11,894,546
29	Komuna Shushicë	Sistemim, asfaltim, ndriçim i qendrës Shushicë	39,795,782	25,581,899
30	Komuna Mollas	Sistemim, asfaltim i rrugëve të fshatit Mollas (faza I)	49,320,013	29,565,989
31	Komuna Bytyç	Sistemim, asfaltim i rrugës Pac - Berishë (Pac - Qafë Nevadi), loti I	52,184,851	20,850,925
32	Komuna Qendër Leskovik	Sistemim, asfaltim i rrugës auto Leskovik - fshati Pobickë - fshati Radat (faza I)	24,709,988	7,325,993
33	Komuna Velçan	Sistemim, asfaltim Qafa e Losnikut - Velçan	70,600,200	25,661,779
34	Bashkia Delvinë	Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vaner	34,928,735	16,525,175
35	Komuna Dishnicë	Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundisht (fazaII)	52,960,444	31,624,669
36	Këshilli i Qarkut Berat	Rikonstruksioni i rrugës Rërez - Kutalli (faza I)	27,319,032	19,319,032
37	Komuna Tërbuf	Rruga e fshatit Shënepremte	40,498,356	16,278,617
38	Komuna Picar	Rikonstruksion i rrugës Picar-Kolonjë-Golem (faza I)	37,777,150	15,166,178
39	Komuna Shtiqën	Asfaltim i rrugës Shtiqën - Uzinë	30,076,515	10,810,322
40	Komuna Fierzë	Sistemim asfaltim i rrugës Kodra e Xanit - Ballë fushe	42,623,960	15,842,629
41	Këshilli i Qarkut Korçë	Rikonstruksion i rrugës kryqëzimi Poloskë - Përparimaj - Cipan	124,966,984	34,586,673
42	Komuna Ngracan	Rikonstruksioni i rrugës Panahor-Ngracan ((faza I)	44,888,000	26,888,000
43	Komuna Cepo	Rikonstruksion, asfaltim i rrugës fshati Mashkullorë	31,436,640	18,861,984
44	Komuna Kelmend	Ndërtim i rrugës Muriq - Qendër Vukël	27,203,028	10,305,272
45	Bashkia Krumë	Infrastruktura e qytetit Krumë, (faza II)	98,736,536	47,920,949
46	Komuna Balldren	Aksi Balldren – Torovicë	59,548,340	35,548,340
47	Komuna	Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim Rrugor në	54,365,182	37,865,182



	Paskuqan	segmentin rrugor; Babrru Qendër - Kodër e Kuqe Puseta		
48	Komuna Bexullë	Sistemin asfaltim i rrugës hekurudhore kufiri ndarës me Kamzën	42,000,000	22,485,834
49	Komuna Bradashesh	Sistemin asfaltim Hotel Europa, Lagjja "Havaleas" dhe nga Kryqëzimi i ish-NMMT uzinës nr. 12.	70,777,812	36,906,200
50	Komuna Milot	Rikonstrukcion i rrugës nacionale Skuraj	69,067,026	40,417,835
51	Bashkia Shkodër	Rikonstrukcioni i fasadës së Radio-Shkodrës	14,703,462	8,822,077
<b>Totali</b>			<b>2,297,619,081</b>	<b>1,050,804,403</b>

Shënim

"Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e paraqitur nga ish-sekretariati teknik përkatës, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për shlyerjen e detyrimeve për projektet në vazhdim, të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë viteve 2012-2013. Kjo vlerë përfaqëson diferencën midis vlerës së kontratës dhe vlerës së paguar të financimit deri më tani.

## VENDIM

Nr. 16, datë 10.10.2014

### PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET NR. 10, DATË 9.7.2014, NR. 11, DATË 1.8.2014, DHE NR. 14, DATË 6.8.2014, SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR SHËNDETËSINË, PROJEKTET E THIRRJES SË KATËRT, SI EDHE SHPALLJEN E THIRRJES SË PESTË PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

#### VENDOSI:

1. Në tabelën 3, që i bashkëlidhë vendimit nr. 10, datë 9.7.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e fondit për art-kulturën, pyllëzime dhe gjelbërim, si edhe ujësjellës-kanalizime, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve", bëhen ndryshime sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 11, datë 1.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e Fondit për Arsimin, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve", bëhen ndryshime sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Në tabelën 2, që i bashkëlidhë vendimit nr. 14, datë 23.9.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për

Zhvillimin e Rajoneve", dhe shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve", bëhen ndryshime sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Shpërndarjen e fondit prej 748 359 782 (shtatëqind e dyzet e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh, për projektet e reja të thirrjes së katërt, për infrastrukturën vendore, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi, me burim financimi, si më poshtë vijon:

a) pjesën e financimit të papërdorur, prej 118 203 724 (njëqind e tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e tre mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh, detajuar në pikën 5, të vendimit nr.12, datë 1.8.2014;

b) pjesën e financimit të disponueshëm, prej 431 267 281 (katërqind e tridhjetë e një milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekësh, për projektet fituese të infrastrukturës vendore të thirrjes së katërt, sipas vendimit nr. 14, datë 23.9.2014;

c) një pjesë të financimit, prej 2 570 000 000 (dy miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, përmes shtesës së parashikuar në ligjin nr. 122/2014, datë 25.9.2014, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014"". Pjesa e mbetur e këtij fondi destinohet për financimin e thirrjes së pestë për projekte, sipas pikës 6, të këtij vendimi.

5. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e shëndetësisë, në vlerën 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, specifikuar sipas tabelës 5, bashkëlidhur këtij vendimi.



6. Shpalljen e thirrjes së pestë për projektet e infrastrukturës vendore, me ndikim për zhvillimin ekonomik të rajoneve, si dhe projekte të vogla vendore, si dhe kërkesat për avancim financimi fondesh, nga financimi 2015, për objekte me ecuri punimesh dhe/ose realizim mbi financimin e 2014, me financim sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi. Procedurat e aplikimit janë të njëjta me ato të ndjekura në thirrjen e mëparshme. Kriteret e vlerësimit të projekteve përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

### KRYETARI Edi Rama

Tabela 1. Ndryshim në tabelën 3, që i bashkëlidhet vendimit nr.10, datë 9.7.2014  
Projekti nr. 1 dhe totali i tabelës nr. 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)
<b>QARKU KORÇË</b>					
1	Bashkia Korçë	Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës	60,000,000	23,819,000	36,181,000
<b>TOTALI</b>			<b>60,000,000</b>	<b>23,819,000</b>	<b>36,181,000</b>

Tabela 2. Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 11, datë 1.8.2014

Projekti nr. 23, i tabelës nr. 2, zëvendësohet me projektet 23 dhe 24, si më poshtë vijon, ndërkohë që totali i tabelës ndryshohet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)
<b>QARKU VLOREË</b>					
23	Bashkia Sarandë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë, Sarandë	46,000,000	15,000,000	31,000,000
24	Bashkia Sarandë	Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane	43,700,000	16,845,200	26,854,800
<b>TOTALI</b>			<b>524,531,095</b>	<b>260,000,000</b>	<b>264,531,095</b>

Tabela 3. Ndryshim në tabelën 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 14, datë 23.9.2014

Projekti nr. 6, i tabelës nr. 2, si edhe totali në fund të tabelës, ndryshohen, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)
<b>QARKU TIRANË</b>					
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Porcelan-Kinostrudio - Surrel	417,207,528	54,106,626	363,100,902
<b>TOTALI</b>			<b>643,763,636</b>	<b>94,000,000</b>	<b>549,763,636</b>



Tabela 4. Projektet e reja për infrastrukturën vendore, thirrja e katërt, për financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Nr	Autoriteti kontraktues	Titulli i Projektit	Vlera e plotë e projektit	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
<b>Qarku Durrës</b>					
1	Bashkia Durrës	Rikonstruksion i rrugës "Erë Pranvere"	50,343,215	15,102,965	35,240,251
2		Rikonstruksion i rrugës "Sulejman Pitarka"	37,743,174	11,322,952	26,420,222
3		Rikonstruksion i rrugës "Porto Roman"	50,182,409	15,054,723	35,127,686
4		Rikonstruksion i rrugës "Pelumbari"	8,197,273	2,459,822	5,737,451
5		Rikonstruksion i rrugës "Durrës Ndërshekuj"	10,640,546	3,192,164	7,448,382
6		Rikonstruksion i rrugës "Tasim Këllici"	50,182,409	15,054,723	35,127,686
7		Rikonstruksion i rrugës "Juba"	50,547,553	15,164,266	35,383,287
8		Rikonstruksion i rrugës "Jezerca"	50,394,370	15,118,311	35,276,059
9		Rikonstruksion i rrugës "Rinia Durrsake"	48,105,455	14,431,637	33,673,819
10		Rikonstruksion i rrugës "Bajram Curri"	43,661,461	13,098,438	30,563,023
<b>TOTALI</b>			<b>399,997,865</b>	<b>120,000,000</b>	<b>279,997,865</b>
<b>Qarku Tiranë</b>					
11	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion i rrugës së Tironsave (rruga hyrëse e qytetit)	190,797,474	57,239,242	133,558,232
<b>Qarku Vlorë</b>					
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Hartimi i projekt-ideve dhe projekteve të zbatimit për transformim dhe përmirësim të hapësirës urbane në disa zona në rajonet Tiranë-Durrës dhe Bregdetin e Jugut	96,600,000	28,980,000	67,620,000
13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Çermë Sektor, Tre urat-Staravec-Gërmenj i Madh, Tre Urat- Autostradë Rrogzhin-Lushnje L=16Km (Unaza Divjakë)	425,016,000	127,504,800	297,511,200
14	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Lidhja e rrugës TransBallkanike me superstradën Fier-Vlorë	641,123,002	192,336,901	448,786,101
15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit anësor dhe hyrjedaljeve në qendrat e banuara në segmentin Levan-Kakavijë	156,371,379	46,911,414	109,459,965
16	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Mbushja me rërë e Plazhit Vlorë (pjesë e projektit Lungomare, Vlorë)	267,986,880	80,396,064	187,590,816
17	Bashkia Orikum	Gjelbërim, sistemim rrugore Pashë Aliman-Orikum Llogara	22,000,000	6,600,000	15,400,000
<b>Qarku Lushnjë-Qarku Berat</b>					
18	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit Anesor dhe vendqendrimeve te perkohshme segmenti rrugor Lushnje - Berat Loti 1	29,691,000	8,907,300	20,783,700
19	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit Anesor dhe vendqendrimeve te perkohshme segmenti rrugor Lushnje - Berat Loti 2	67,829,712	20,348,914	47,480,798
20	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit Anesor dhe vendqendrimeve te perkohshme segmenti rrugor Lushnje - Berat Loti 3	39,279,600	11,783,880	27,495,720
<b>Qarku Korçë</b>					
21	Komuna Çlirim	Rruga Qafezëzë - Sokole - Psari i zi	20,000,000	6,000,000	14,000,000
<b>Qarku Shkodër</b>					
22	Bashkia Shkodër	Pyllëzimi i objektit Kodra e Tepes	3,876,038	1,162,811	2,713,227



23	Bashkia Shkodër	Punimet Sivikulturale në pyjet artificial	3,232,522	969,757	2,262,765
<b>Qarku Fier</b>					
24	Komuna Portëz	Rruga lidhëse midis një grupi fshatrash (Mbyet, Pluk, Krraps, Lalar)	392,187,000	39,218,700	352,968,300
<b>TOTALI</b>			<b>2,755,988,472</b>	<b>748,359,782</b>	<b>2,007,628,690</b>

Shënim

- 1."Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të)
- 2."Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
- 3.Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014, do të financohet nga FZHR për vitin 2015.

Tabela 5. Projektet për shëndetin parësor, për financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera për financim 2014 (lekë)	Vlera për financim 2015 (lekë)
<b>QARKU FIER</b>				
Bashkia Divjakë	Ndërtimi i Qendrës Spitalore, Divjakë	52,400,000	12,195,000	40,205,000
Bashkia Divjakë	Supervizion për ndërtimin e Qendrës Shëndetësore Bashkia Divjakë	730,000	730,000	0
Bashkia Divjakë	Kolaudim për ndërtimin e Qendrës Shëndetësore Bashkia Divjakë	75,000	75,000	0
<b>TOTALI</b>		<b>53,205,000</b>	<b>13,000,000</b>	<b>40,205,000</b>

Shënim

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
2. "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2015.

## SHTOJCA I KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

### A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga 0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.



Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si pjesë e sekretariatit teknik, ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial të paraqitura nga aplikantët, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatitë raportin e vlerësimit financiar të tyre e rekomandimet përkatëse.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

3. Ndikimi i projektit, që vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë, sipas komponentëve, si më poshtë vijon:

a) prek qendërqarkun dhe ndikon në zhvillimin ekonomive vendore, konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin 0 deri 5 pikë.

b) ka rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuara biznesi. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

c) rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

ç) projekti ndikon në rehabilitimin mjedisor dhe krijimim e korridoreve të gjelbër ndërqytetas, si dhe në zona turistike. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

4. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

#### B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Këto kritere përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, maksimalisht, 30 pikë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qëndërqarqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëri dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.



**VENDIM**  
**Nr. 49, datë 29.9.2014**

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE  
 PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË  
 GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK,  
 BAZUAR NË LIGJIN NR. 116, DATË  
 15.4.2013 “PËR RATIFIKIMIN E  
 MARRËVESHJES ME QEVERINË E  
 VENDIT PRITËS NDËRMJET  
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DUKE  
 VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË  
 MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIK  
 PIPELINE AG, LIDHUR ME PROJEKTIN  
 E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK  
 (PROJEKTI TAP), SI DHE TË  
 MARRËVESHJES NDËRMJET  
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
 PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I  
 MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIK  
 PIPELINE AG, NË LIDHJE ME  
 PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS  
 ADRIATIK (PROJEKTI TAP)”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtare
Edmond Ademi	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 29.9.2014, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

**I. PROCEDURA**

1. Me shkresën nr. 3407/3 datë 11.7.2014, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) njoftoi pranë Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) masën e sipërpërmendur. MZHETS, me shkresën nr. 5802 datë 30.7.2014, i kërkoi informacion shtesë MEI-it për masën e njoftuar. MEI me shkresën nr. 4682/2 datë 14.8.2014 dërgoi të dhëna shtesë lidhur me zbatimin e projektit TAP.

**II. PËRSHKRIMI I MASËS**

**a) Përshkrimi i projektit**

2. Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është një projekt i ri i rëndësishëm, ndërshtetëror, i cili do të

transportojë gaz natyror të prodhuar nga vendburimi “Shah Deniz II” në Azerbajxhan, duke e përcjellë tranzit nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, përtej Detit Adriatik në Leçe (në Italinë Jugore), për t'u lidhur me rrjetin e transportit të gazit në Itali dhe e shpërndarë në vende të tjera të Evropës. Projekti TAP, përveç mundësisë që ofron për “rrjedhje komerciale të gazit”, do të përfshijë edhe “rrjedhjen fizike të gazit në drejtimin e kundërt” në drejtimin e kundërt (*reverse flow*), që do të lejojë që gazi të drejtohet nga Italia për në Evropën Juglindore, nëse furnizimet me gaz (me energji) do të mungojnë në këtë rajon, ose nëse nevojitet për të mundësuar furnizimin me më shumë sasi gazi në të.

3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka njoftuar se qëllimi i projektit është të transportojë gaz natyror nga rajoni i Kaspikut, nëpërmjet një gazsjellësi me diametër 48" në tokë dhe 36" në det, deri në një terminal pritës në tokë pranë Leçes (Itali), duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e sigurisë dhe diversifikimit të furnizimeve me gaz për tregjet evropiane.

4. Gjurma e TAP do të jetë afërsisht 870 km, duke u shtrirë afërsisht: në Greqi 550 km; në Shqipëri 210 km; *offshore* (në det të hapur) në Detin Adriatik 105 km; në Itali 8 km. Kuota më e lartë e shtrirjes së gazsjellësit TAP do të jetë 1800 m në Shqipëri, ndërsa kuota më e ulët do të jetë 810 metra në thellësi të Detit Adriatik.

5. TAP do të ofrojë rrugën e transportit më të drejtpërdrejtë dhe më me efikasitet ekonomik, duke hapur [Korridorin Jugor të Gazit](#) për Europën, që do të përbëjë një sistem të transportit të gazit 4000 km të gjatë me vlera gazifikimi, që shtrihet nga deti Kaspik e deri në Evropë. Pika e fillimit të gazsjellësit në territorin grek është në Kipoi në afërsi të kufirit greko-turk, ku do të ndërlidhet me gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP), ndërsa pika e daljes në territorin italian në San Foca (Leçe). Korridori ku do të kalojë projekti TAP në territorin shqiptar shtrihet në 38 bashki dhe komuna të qarkut Korçë, qarkut Berat dhe qarkut Fier.

6. Kapaciteti transportues i gazsjellësit do të rritet nga një vlerë fillestare prej 10 miliardë m<sup>3</sup> gaz në vit (BCMY) deri në 20 miliardë m<sup>3</sup> gaz në vit (BCMY). Gjurma e TAP hyn në pjesën kontinentale shqiptare në jug të qytetit të Bilishtit, vazhdon në fushën e Devollit dhe të Korçës, më pas kalon në qytetin e Çorovodës, e anashkalon



qytetin e Beratit në veri, kalon qytetin e Fierit për në Seman dhe Topojë deri në seksionin shqiptar të daljes në det, nga ku seksioni në det kalon përmes detit Adriatik deri në Leçe të Italisë.

7. Komponentët kryesore të projektit TAP në territorin shqiptar në tokë dhe në det, janë si më poshtë:

- Një tubacion 48", afërsisht 210 km i gjatë, i futur nëntokë që përshkon vendin nga kufiri Greqi - Shqipëri deri në stacionin e kompresorëve në Topojë Fier (SK03);

- Një tubacion 36", nga stacioni i kompresorëve në Topojë Fier (SK03), deri tek dalja nga toka në det në brigjet e detit Adriatik, afërsisht 60 km i gjatë në territorin detar të Shqipërisë;

- Stacion matës/kompresimi në afërsi të Bilishtit, Korçë (SK02), objektet dhe rrjeti elektrik i lidhur me të (linjë e tensionit të mesëm, afërsisht 1.5 km e gjatë) pranë kufirit Shqipëri - Greqi;

- Stacion kompresimi (SK03) dhe rrjeti elektrik i lidhur me të (linjë e tensionit të mesëm, afërsisht 8 km e gjatë) pranë qytetit të Fierit;


- Afërsisht 10 stacione valvulash të bllokimit (BVS) përgjatë gjurmës në tokë, në intervale prej një maksimumi 30 km, për të ndërprerë rrjedhën e gazit në rast mirëmbajtjeje, apo emergjence;

- Rrugët hyrëse për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e tubacionit dhe infrastrukturës së tij;

- Punime të tjera të përkohshme si sheshet për vendosjen e tubave, kampet e punëtorëve, etj.

8. Pranë kufirit Shqipëri-Greqi, një stacion matjeje do të zgjerohet duke u shndërruar në një stad të mëvonshëm në një stacion kompresori (SK02), për të rritur kapacitetin e gazsjellësit në 20 mmk/vit. Përtej daljes në det, e cila është afërsisht 6 km në perëndim të SK03, gazsjellësi do të shtrihet afërsisht 60 km në det drejt kufirit Shqipëri-Itali në vijën e mesme të detit Adriatik. Gjithashtu do të ndërtohet dhe një terminal (TPG) për pritjen e gazsjellësit në Leçe të Italisë. Në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, do të instalohen stacione të valvulave të bllokimit në intervale prej rreth 20 km përgjatë gazsjellësit tokësor për të ndërprerë rrjedhjet e gazit në rast mirëmbajtjeje ose ndërhyrjesh me emergjencë.

Figura 1. Korridori jugor i gazit për Europën dhe projekti TAP si pjesë e këtij korridori



b) Baza ligjore

9. Baza ligjore është ligji nr. 116, datë 15.4.2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline

AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”.

c) Karakteristikat e përfituesit

10. Projekti i gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), është i një rëndësie strategjike duke krijuar mundësinë që Shqipëria të bëhet një vend qendror tranziti për sigurinë e energjisë së Bashkimit Evropian, por edhe në diversifikimin e burimeve të furnizimit me gaz.



11. Kompania TAP AG është themeluar në datën 13.3.2007 me seli në Baar, Zvicër. Investitori ka përgjegjësi të ndërtojë dhe mundësojë operimin e gazsjellësit Trans Adriatik. Kompania kryen aktivitetin e transmetimit të gazit natyror si në seksion tokësor ashtu dhe në atë detar.

d) Financimi: buxheti dhe kohëzgjatja

12. Investimi total për transportimin e gazit nëpërmjet Korridorit Jugor të Gazit është llogaritur të jetë rreth 40 miliardë USD. Ndërkohë vlera e investimit të gazsjellësit TAP në Shqipëri do të jetë rreth 1,5 miliardë USD, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve për ndërtimin e tubacionit, ndërtimin e tubacioneve në tokë dhe në det, rregullim infrastrukture në Shqipëri, ndërtimin e stacioneve të kompresorëve, ndërtimin e terminalit (TPG) për pritjen e gazsjellësit në Itali, ndërtimin e valvulave, blerjen e tokave të cilat do të ndikohen nga kalimi i rrugëve, tubacionit apo stacioneve të kompresorëve, etj.

13. Financimi i investimit do të jetë nga aksionarët e kësaj kompanie: BP, SOCAR, Statoil, Fluxys, Total, E.ON dhe Axpo. Projekti TAP do të zbatohet në dy faza. Faza e I-rë, parashikon një kapacitet të gazsjellësit për transportin e 10 BCMY. Faza e II-të, parashikon rritjen e kapacitetit deri në 20 BCMY.

III. Situata aktuale e tregut të gazit në Shqipëri, parashikimet për të ardhmen dhe përafrimi me legjislacionin evropian

14. Sigurimi i burimeve primare të energjisë për vendin tonë, për vitin 2012, ka qenë në nivelin 2014.15 ktoe<sup>1</sup>. Kontributi i hidrokarbureve në 2012 ishte 1068.46 ktoe, ose 53.1 % e totalit. Produktet hidrokarbure kanë një rënie në konsumin e energjisë nga 57.2 % në vitin 1999, dhe 53.1 % në 2012.

15. Prodhimi i gazit natyror në Shqipëri nga viti 1971 është rritur deri në vitin 1980, ku arriti kulmin e tij me 0.4 billion m<sup>3</sup>. Më pas prodhimi i gazit natyror ra ndjeshëm deri në 1990 dhe më pas u ndal. Në periudhën e dy dekadave të fundit, ky prodhim është përdorur vetëm për konsum në rafineri dhe në vendburimet për prodhimin e gazit dhe naftës. Kapacitetet e

prodhimit të gazit janë në limitet minimale, totali i rezervave të gazit natyror në vend janë 57 milion m<sup>3</sup>. Në vitin 2012, prodhimi lokal i gazit natyror dhe gazit shoqërues të naftës ka qenë në vlerat e 17 milion m<sup>3</sup>.

16. Zhvillimet për këtë sektor në të ardhmen lidhen me realizimin e projekteve të gazsjellësit TAP dhe IAP, ku konsumi i gazit natyror vlerësohet të rritet në nivelet 1.6 BCMY deri në vitin 2030. Pjesa që do të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike, në konsum total të parashikuar të gazit parashikohet të jetë 65-70% në vitin 2030.

17. Fillimisht, gazi natyror parashikohet të jetë në dispozicion për përdorim të industrive të mëdha dhe të energjisë termike për prodhimin e energjisë elektrike (0.4 BCM në 2020), pra gazi natyror do të konsumohet në të gjithë sektorët e tjerë. Penetrimi i madh në sektorin familjar dhe atë të shërbimit do të fillojë në mes të vitit 2020 dhe do të vazhdojë duke u rritur deri në 2030. Është vlerësuar se kontributi i gazit natyror në konsumin final të energjisë do të arrijë deri në 37%. Kërkesa e gazit natyror për tregun shqiptar në 2030 parashikohet të arrijë në rreth 1.6 miliardë m<sup>3</sup>.

18. Shqipëria është nënshkruese e Traktatit për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë”, të ndryshuar. Në bazë të detyrimeve që përcakton Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë Shqipëria, si palë kontraktuese e këtij Traktati, ka implementuar Paketën e Dytë të Energjisë të BE-së, ku përfshihet direktiva 2003/55/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 26.6.2003, e cila lidhet me rregullat për tregun e brendshëm të gazit natyror. Mbi këtë bazë është miratuar ligji nr. 9946 datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.

#### IV. VLERËSIMI

##### 1. Ekzistenca e ndihmës shtetërore

19. Neni 4 i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë

<sup>1</sup> Tons of Oil Equivalent.



konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

Ndihma e dhënë nga burimet shtetërore

20. Marrëveshja e projektit TAP, në nenin 24 “Taksat”, pika 24.10 parashikon se “Shteti pranon se TVSH-ja nuk duhet të jetë kosto për Projektin (si direkt, ashtu dhe nëpërmjet mekanizmit të vetëfaturimit), duke qenë se qëllimi i Projektit nuk është ofrimi i mallrave, punëve apo shërbimeve për konsum përfundimtar brenda Shtetit, por ofrimi i shërbimeve për transportuesit që veprojnë si persona të tatueshëm jashtë territorit shqiptar, i cili është në të njëjtën linjë me parimin e paanshmërisë së sistemeve të TVSH-së, për të pajisur bizneset me aktivitet të tatueshëm me një të drejtë të përgjithshme për rimbursimin e TVSH-së”. Ligj nr. 92, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”<sup>2</sup>, neni 24, parashikon se: “Vendi i furnizimit të shërbimit është në Republikën e Shqipërisë nëse marrësi i shërbimit, një person i tatueshëm që sillet si i tillë, ka në Republikën e Shqipërisë: a) selinë e veprimtarisë të tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet; ose b) banesën ose rezidencën e zakonshme, në mungesë të një selie të veprimtarisë ekonomike apo të një vendndodhjeje të qëndrueshme”.

Duke parë se në marrëveshjen e projektit TAP, rezulton se furnizues i shërbimit është Investitori i Projektit, ndërmarrja TAP AG, marrës të shërbimit janë transportuesit, për të cilët selia e veprimtarisë së tyre ekonomike nuk është Republika e Shqipërisë, në interpretim të ligjit nr. 92, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, vendi i furnizimit të shërbimit të transportit të gazit natyror nuk është Republika e Shqipërisë.

Sa më lart, masa e ndihmës shtetërore e përcaktuar në këtë nen, është konform parashikimit të nenit 24 , pika 1 e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, dhe si rrjedhim nuk aktivizon burime shtetërore.

21. Në lidhje me kompensimet e mundshme, të çfarëdolloj natyre, marrëveshja e projektit TAP, në nenin 24 “Taksat”, pika 24.13 parashikon se: “Çdo kompensim, duke përfshirë çdo interes mbi këtë kompensim, i marrë nga Investitori i Projektit nga çdo shtet palë në bazë të kësaj ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose çdo marrëveshje tjetër të Projektit, nuk do të jetë objekt i asnjë forme tatimi nga ndonjë autoritet shtetëror”. Gjithashtu, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pika 9, parashikon se “Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore”.

Për rrjedhim, vlerësojmë se përjashtimi nga tatimi i çdo kompensimi i marrë nga Investitori i Projektit, sipas nenit 24.13 e marrëveshjes së projektit TAP, nuk konsiderohet se aktivizon burime shtetërore, sepse kjo masë është e parashikuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

22. Në formularin e njoftimit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, argumenton se mungesa e aplikimit të “*maritime domain/concession fee*” në marrëveshjen e projektit TAP, mund të aktivizojë burime shtetërore. Bazuar në legjislacionin shqiptar për konçensionet<sup>3</sup>, si edhe nga shqyrtimi i praktikës të zbatuar deri më tani lidhur me projekte konçensionare të zbatuara në Shqipëri, rezulton se nuk është miratuar dhe vendosur një tarifë konçensionare për një projekt konçensionar në ambjent nënujore.

Në bazë të legjislacionit për konçensionet<sup>4</sup>, organi përgjegjës për sektorin në të cilin do të jepet konçesioni, në rastin konkret Ministria e Energjisë dhe Industrisë, i propozon Këshillit të Ministrave përcaktimin e autoritetit kontraktues, duke miratuar fillimin e procedurave për dhënien me konçension.

Përsa më sipër, vlerësohet se mungesa e aplikimit të “*maritime domain/concession fee*” në marrëveshjen e projektit TAP, nuk aktivizon burime shtetërore, me argumentin se tarifa konçensionare nuk është e vendosur në legjislacionin shqiptar, për më tepër e zbatuar në projekte të tjera të ngjashme konçensionare.

<sup>2</sup> I përafuar pjesërisht me: Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2006/112/KE, datë 28 /11/ 2006, “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”

<sup>3</sup> Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për konçensionet”, i ndryshuar,

<sup>4</sup> VKM nr. 27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve”, kreu II “Identifikimi i konçesionit të mundshëm”.



23. Marrëveshja e projektit TAP, në nenin 47 “Bashkëpunimi për financimin e projektit”, pika 1, shkronja d), parashikon se shteti bie dakord të bashkëpunojë me Investitorin e Projektit në kërkimin e këtij financimi të kufizuar ose me garanci të kufizuara, të bazuar në borxh ose financim titujsh për Projektin, ku citohet: “të nënshkruajë ato dokumente të tjera që janë të nevojshme ose të përshtatshme për të shtrirë te të gjithë huadhënësit e mundshëm garancitë, deklaratimet, siguritë, angazhimet, sipërmarrjet dhe detyrimet e Shtetit në formën dhe në masën e përcaktuar në këtë Marrëveshje”. Sipas nenit 34 të ligjit për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas<sup>5</sup>, miratimi i garancisë shtetërore për huan nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Në bazë të nenit 4, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një garanci shtetërore mbi kreditë ose dhënia e kredive me norma interesi të ulëta mund të aktivizojë burime shtetërore<sup>6</sup>.

24. Në marrëveshjen e projektit TAP, pjesën “Shtojcat e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës”, shtojca 1 “Toka e projektit”, pika 8 “Kompesimi financiar”, shkronja c), nëse Investitori i Projektit fiton të drejtat përkatëse mbi tokën shtetërore, në paragrafin ii) parashikohet se Investitori i Projektit “për aq sa një person i prekur është palë shtetërore, paguan kompensim financiar në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës”. Në bazë të nenit 4, pika 2, shkronja “g” të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ulja e çmimit të produkteve të ofruara, ose shitja e pronës shtetërore nën çmimin e tregut, mund të aktivizojë burime shtetërore.

Avantazhi për Investitorin e Projektit

25. Nëse gjatë zbatimit të marrëveshjes, shteti do të lëshojë një garanci shtetërore dhe ndërmarrja do të përfitojë kredi me terma favorizuese, atëherë masa jep një avantazh ekonomik për investitorin e projektit. Miratimi i garancisë shtetërore apo pagesa e kompesimit

financiar për pronën shtetërore nën vlerën e tregut, mund të aktivizojë burime shtetërore duke i siguruar përfituesit, ndërmarrjes TAP AG, fonde shtesë për të mbuluar koston e investimit për ndërtimin e gazsjellësit Trans Adriatik në Shqipëri. Në kushte normale të tregut, përfituesi do të duhet të sigurojë mbulimin e një pjesë të koston së investimit me burime të veta financiare<sup>7</sup>. Përderisa ky avantazh jepet vetëm për ndërmarrjen TAP AG, Komisioni arrin në përfundimin se masa ka një natyrë selektive.

Efektet në konkurrencë

26. Mbështetja shtetërore e parashikuar në njoftimin e projektit të marrëveshjes TAP, përmirëson aftësinë e ndërmarrjes TAP AG për të konkurruar në tregun e gazit në Shqipëri, ndërkohë që ndërmarrje të tjera do të mund të jenë të pranishme në të ardhmen<sup>8</sup>. Për më tepër, ndihma e mundshme do të forcojë pozitën e ndërmarrjes TAP AG, duke favorizuar zhvillimin e infrastrukturës së gazit në vend, dhe krijuar potencialin për të ndikuar në modelet e konkurrencës mes shfrytëzimit të energjisë dhe burimeve të tjera, të cilat janë pjesërisht të zëvendësueshme me gaz, të tilla si burimet ujore, qymyrguri etj. Duke qenë se gazi dhe produkte të tjera të energjisë tregtohen në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe ato të rajonit, zbatimi i projektit të njoftuar, do të ndikojë në kushtet tregtare në të gjithë BE-në<sup>9</sup>.

Konkluzion mbi ekzistencën e ndihmës shtetërore

27. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që i bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, mund të aktivizojë burime shtetërore.

2. Ligjshmëria e ndihmës

28. Dhënia e ndihmës është objekt i miratimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka

<sup>5</sup> Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>6</sup> State Aid SA.36740 (2013/NN) – Lithuania Aid to Klaipėdos Nafta – LNG Terminal

<sup>7</sup> State Aid SA.35164 (2013/NN) – Greece – Compressor Station in Nea Messimvria

<sup>8</sup> State Aid SA.35167 (2013/NN) – Greece – High Pressure Natural Gas Pipeline to Ag. Theodori - Megalopoli

<sup>9</sup> State Aid No SA.35255 2012/N – Poland Aid to PSE Operator S.A. for the construction of Stanisławów station, part of the Poland-Lithuania electricity link Project



përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 13 “ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke e njoftuar masën e ndihmës përpara vënies në zbatim të saj. Ministria e Energjisë dhe Industrisë duhet të njoftojë në të ardhmen çdo ndryshim të masës së ndihmës.

3. Përputhshmëria me nenin 13 (2) të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar

29. Objektivi kryesor i ndihmës është zhvillimi i sistemit të transmetimit të gazit dhe ndërlidhja e saj me vendet e rajonit, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës bazë për funksionimin e tregut të brendshëm të gazit në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian. Komisioni konsideron se vlerësimi i përputhshmërisë së masës kërkon një vlerësim të kontributit të projektit në zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri, dhe për këtë arsye duhet të bazohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenin 13, pika 2 të ligjit për ndihmën shtetërore, i cili parashikon se ndihma mund të lejohet nëse “nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë ose jepet për të mënjanuar situata të rënda në ekonominë e Republikës së Shqipërisë”.

30. Masa e ndihmës shtetërore mund të konsiderohet në përputhje të drejtpërdrejtë me nenin 13, pika 2, të ligjit për ndihmën shtetërore, nëse masa është e nevojshme dhe proporcionale dhe nëse efektet pozitive kalojnë efektet negative që lidhen me konkurrencën dhe tregtinë<sup>10</sup>.

31. Greqia, Shqipëria dhe Italia do të përfitojnë ndjeshëm në një nivel strategjik nga prania e TAP-it në vendet e tyre, duke gëzuar një status të përforcuar në hartën energjetike evropiane si rrugë kalimi rajonale dhe njëje energjetike. Përfitimet që do të sjellë projekti TAP për Shqipërinë përfshijnë:

- Kontribut të drejtpërdrejtë në prodhimin e brendshëm bruto (PBB) përmes sistemit tatimor;
- Punësim të drejtpërdrejtë edhe gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të gazsjellësit;
- Prokurim të mirash dhe shërbimesh përmes furnitorëve të pranueshëm;

- Programe të përmirësimit të aftësive: aftësi të reja dhe ekspertizë për kompanitë dhe punonjësit;

- Investime sociale dhe mjedisore: programet e investimeve në komunitet;

- Infrastruktura e përmirësuar vendore: për shembull, rrugë dhe ura në Shqipëri,

- Fuqizimi i rolit të vendeve pritëse si nyje energjetike në rajon.

32. Projekti TAP do të zhvillojë infrastrukturën energjetike shqiptare dhe do të tërheqë investime të huaja të rëndësishme në vend. Ky projekt do të nxisë aktivitetin ekonomik, duke hapur vende të reja pune dhe duke zhvilluar aftësitë dhe potencialet prodhuese dhe shërbimit në vend. Gazsjellësi do të ndihmojë Shqipërinë të vazhdojë integrimin e saj tregtar dhe fizik me Evropën, duke rritur rëndësinë rajonale dhe gjeostrategjike të vendit, duke promovuar stabilitet të vazhdueshëm. Projekti TAP mund të mbështesë gjithashtu Shqipërinë në përmbushjen e nevojave të veta energjetike në të ardhmen, duke zhvilluar një treg të brendshëm energjetik dhe mbështetur zhvillimin e tregut të gazit natyror në Shqipëri.

33. Si një nga zhvillimet infrastrukturore energjetike më të rëndësishme në Evropë, projekti TAP vlerësohet të ofrojë mundësi për kompani vendase dhe ndërkombëtare lidhur me volumin e punës, si furnitorë dhe ofrues shërbimesh. Projekti TAP gjithashtu do të ndihmojë këto kompani në zhvillimin e aftësive të tyre dhe ekspertizës së nevojshme për zbatimin e këtij projekti, si edhe projekteve të ardhshme në infrastrukturë.

#### 4. Konkluzione

34. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se masa e ndihmës, e cila mbështet ndërtimin gazsjellësit Trans Adriatik, një projekt i cili kontribuon në realizimin e interkoneksionit të gazit të prodhuar në Shah Denis II, Azerbajxhan për t'u shpërndarë dhe avancuar në Itali dhe vende të tjera të Evropës, nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët në një mënyrë të nevojshme dhe proporcionale dhe për këtë arsye është në përputhje me nenin 13, pika 2 e ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

<sup>10</sup> State aid N 594/2009 Aid to Gaz-System S.A. for gas transmission networks in Poland



## PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, shkronja “ç”, 22, pika 2, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

## VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), të parashikuar në ligjin nr. 116, datë 15.4.2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, mbështetur në nenin 13, pika 2 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë të njoftojë pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore skemën e ndihmës shtetërore, në rast se gjatë zbatimit të marrëveshjes për projektin TAP, shteti do të hyj në një marrëdhënie me bankën, dhe për më tepër të lëshojë një garanci shtetërore, në bazë të nenit 4, pika 2, shkronja “e” e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në rastin e zbatimit të pikës 8, shkronja “c”, germa “ii”, të shtojcës 1 të ligjit nr. 116, datë 15.4.2013, të kontrollojë nëse vlera e kompensimit financiar e paguar nga ana e investitorit të projektit, sipas planit të rehabilitimit të jetesës, reflekton vlerën e tregut. Hartimi dhe zbatimi i planit të rehabilitimit të jetesës duhet t'i nënshtrohet një procesi të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës, me qëllim që masa e kompensimit financiar të jetë e orientuar drejt asaj të tregut, në rast të kundërt, masa aktivizon burime shtetërore dhe si e tillë duhet të njoftohet pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore. Për këtë qëllim, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, për tokën që jepet nën çmimin e tregut, të bëjë llogaritjen e vlerës reale

të saj nga ekspertë të pavarur dhe, mbi këtë bazë, të llogaritet kontributi financiar që do të duhet të paguajë Investitori i Projektit.

4. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, bazuar në nenin 20, pika 1 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj

**VENDIM**  
**Nr. 50, datë 1.10.2014**

**PLANI I NDIHMËS SHTETËRORE**  
**“PËR KRIJIMIN E FONDIT NË**  
**MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE TË**  
**REJA “START-UP””**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtare
Edmond Ademi	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 1.10.2014, shqyrtoi raportin për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up””. Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr. 4808/4, datë 9.7.2014 dhe është regjistruar në regjistrin me nr. Al/N/16/2014.

**OBJEKTIVI I SKEMËS SË NDIHMËS:**  
Skema synon të nxisë krijimin dhe konsolidimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.



BAZA LIGJORE E SKEMËS: Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up””, i iniciuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

#### VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të regjistruara pranë QKR-së, për një periudhë nga 1 deri në 2 vjet.

2. Ndhma do të jepet ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në sektorët prodhues dhe të shërbimit, sektorin e industrisë së lehtë, sektorin e turizmit, fushën e kërkimit dhe të zhvillimit, në procesin e agropërpunimit dhe në fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

3. Ndhma do të jepet në formën e grantit. Shuma gjithsej e ndihmës është 25 000 000 lekë. Ndhma për një ndërmarrje do të jepet për mbulimin e 70 % të kostove të pranuar, por nuk do të kalojë shumën 300 000 lekë.

4. Kosto të pranueshme janë:

- investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/shërbimit;

- marketingu i produktit dhe promovimi;

- kualifikimi dhe trajnimi për rritjen e aftësive sipërmarrëse;

- krijim faqe interneti, publikime materiale promovuese;

- pjesëmarrje në një panair ose ekspozitë brenda apo jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

5. Skema e njoftuar do të fillojë të zbatohet në vitin 2014, dhe do të zgjasë 4 vite.

6. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

7. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema e njoftuar përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Ndhma jepet nga autoritete publike, përmes burimeve shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9374 datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

- Skema ndikon në uljen e shpenzimeve për krijimin e ndërmarrjeve në vend, duke i dhënë një avantazh, i cili mund të ndikojë ose të kërcënojë të dëmtojë konkurrencën.

- Skema është selektive, sepse ndihma jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh.

- Skema lidhet me sektorë dhe ndërmarrje, të cilët janë të përfshirë në tregtinë me shtetet e rajonit, dhe mund të ndikojë në tregtinë ndërshtetesh.

8. Skema e njoftuar është në përputhje me nenin 9/1 “Ndhma për ndërmarrjet e vogla, të sapokrijuara” të ligjit të ndihmës shtetërore, shkronja “a”, ku vlera e ndihmës nuk e kalon masën 200 000 euro dhe shkronjën “b” ku vlera vjetore nuk duhet të kalojë 33 për qind të vlerës së ndihmës së parashikuar në shkronjën “a”.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 9/1, 13, pika 3, 22, pika 2, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e njoftuar të ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up””.

2. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

3. Të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj



## VENDIM

Nr. 51, datë 1.10.2014

### PLANI I NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT NË MBËSHTETJE TË GRAVE SIPËRMARRËSE”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtare
Edmond Ademi	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 1/10/2014, shqyrtoi raportin për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse”. Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr. 4808/4, datë 9.7.2014 dhe është regjistruar në Regjistrin me nr. Al/N/17/2014.

**OBJEKTIVI I SKEMËS SË NDIHMËS:** Skema lehtëson veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve që drejtohen nga gratë, duke ndikuar në përmirësimin e klimës dhe kushteve operuese të sipërmarrjes femërore, dhe kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

**BAZA LIGJORE E SKEMËS:** Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse”, i iniciuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

#### VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të cilat drejtohen nga gratë.

2. Ndihma do të jepet ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në sektorët prodhues dhe të shërbimit, në industrinë e përpunimit aktiv (fason), në sektorin e turizmit, në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit, në procesin e agropërpunimit, në fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

3. Ndihma do të jepet në formën e pagesës së interesave për kreditë e marra nga gratë dhe që do

të përdoren për investime në biznes. Vlera gjithsej e ndihmës është 26 500 000 lekë. Për një ndërmarrje, skema do të mbulojë 50 % të normës së interesit, për 4 vite radhazi dhe jo më shumë se 1 000 000 lekë për një kredi.

4. Skema e njoftuar do të fillojë të zbatohet në vitin 2014, dhe do të zgjasë 4 vite.

5. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema e njoftuar përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Ndihma jepet nga autoritete publike, përmes burimeve shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar.

- Skema ndikon në mbulimin e gjysmës së kostos së huamarrjes, duke i dhënë një avantazh, i cili mund të ndikojë ose të kërcënojë të dëmtojë konkurrencën.

- Skema është selektive, sepse ndihma jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh.

- Skema lidhet me sektorë dhe ndërmarrje, të cilat janë aktive në tregtinë me shtetet e rajonit.

7. Skema e ndihmës e njoftuar është në përputhje me nenin 13, pika 3 “Ndihma shtetërore që mund të lejohet” të ligjit të ndihmës shtetërore, ku nëpërmjet subvencionit të huave për kryerjen e investimeve nga ndërmarrjet do të kontribuojë në zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 13, pika 3, 22, pika 2, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e njoftuar të ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse”.





2. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

3. Të japë çdo informacion që do të kërkohej për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj

**VENDIM**  
**Nr. 52, datë 1.10.2014**

**PËR SKEMËN E NDIHMËS**  
**SHTETËRORE “VENDIMI I KËSHILLIT**  
**BASHKIAK TIRANË NR. 20, DATË 9.4.2013**  
**“PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË**  
**ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE**  
**PUNËSIMIT “SKEMA E FONDIT TË**  
**GARANCISË” SI DHE MIRATIMIN E**  
**KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR**  
**PËRZGJEDHJEN E BANKËS SË NIVELIT**  
**TË DYTË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtare
Edmond Ademi	anëtar
Ahmet Maçellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 1.10.2014, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, ka marrë në shqyrtim *ex-post* vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 20, datë 9.4.2013 “Për zbatimin e programit të zhvillimit ekonomik dhe punësimit “Skema e fondit të garancisë” si dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë”, të vënë në zbatim nga Bashkia e Tiranës.

1. Procedura

i) Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, me

shkresën nr. 175, datë 14.1.2014, MZHETS ka informuar Bashkinë e Tiranës se përmbajtja e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 9.4.2013, përmban elemente të ndihmës shtetërore. Bashkisë Tiranë iu kërkuar njoftimi i skemës së ndihmës së ndihmës shtetërore, nëpërmjet plotësimit të formularit të njoftimit të ndihmës, siç përcaktohet në nenin 20, pika 1, të ligjit për ndihmën shtetërore, si dhe të dispozitave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817 datë 28.12.2005 “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, si dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës për krijimin e këtij fondi garancie.

ii) Në mungesë të përgjigjes nga Bashkia e Tiranës, MZHETS-ja me shkresën nr. 175, datë 26.2.2014, përsëriti kërkesën për njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore, të krijuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 9.4.2013.

iii) Në mungesë të përgjigjes nga Bashkia e Tiranës, MZHETS-ja me shkresën nr. 175/1, datë 6.5.2014, i kërkoj sërish njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore, të krijuar me vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 9.4.2013. Në kërkesë, MZHETS-ja e bëri me dije autoritetin e Bashkisë Tiranë se duhet të respektonte parashikimet e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, për të kërkuar paraprakisht një autorizim nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Në mungesë të njoftimit<sup>11</sup>, vazhdimi i zbatimit të fondit bashkiak të garancisë, e bën ndihmën e paligjshme.

2. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

a) Titulli i skemës

Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 20, datë 9.4.2013 “Për zbatimin e programit të zhvillimit ekonomik dhe punësimit “Skema e fondit të garancisë”, si dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë”.

b) Buxheti

Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 9.4.2013 ka miratuar zbatimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, nëpërmjet buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013, në formën e projektit “Skema e Fondit të Garancisë”, në shumën 100.000.000 lekë.

<sup>11</sup> Ligji nr.9374, datë 21.05.2005 “Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar, neni 20 “Njoftimi i ndihmës”.



c) Përfituesi

- Biznese me natyrë prodhuese, bazë për eksport

- Biznese që aplikojnë për zbatimin e projekteve të inovacionit dhe teknologjisë

- Biznese me impakt pozitiv në mjedis

- Biznese që kontribuojnë në rritjen e punësimit

- Biznese që forcojnë rolin e gruas në ekonomi, kryesisht sipërmarrëset femra

- Biznese që inkurajojnë punësimin e të rinjve, kryesisht sipërmarrës të rinj deri në 35 vjeç

d) Objektivi

Fondi i garancisë synon nxitjen e dhënies së kredisë, për të mbështetur krijimin e bizneseve të reja apo zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të ndërmarreve ekzistuese, të cilave ju është refuzuar miratimi i huas në mungesë kolaterali.

3. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

i) Në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) sjell pasojë mbi konkurrencën.

ii) Në dokumentet e konkurrimit<sup>12</sup>, bankat konkurruese për përdorimin e Fondit Bashkiak të Garancisë do të paraqesin propozime, projeksione dhe tregues të performancës nga zbatimi i skemës së kreditimit mbështetur nga Fondi Bashkiak i Garancisë, si numri i bizneseve që trajtohen, numri i bizneseve të reja që do hapen dhe efekte që krijojnë një vlerë të shtuar për ekonominë dhe punësimin në qytetin e Tiranës.

iii) Në kriteret e përzgjedhjes së bankës së nivelit të dytë<sup>13</sup>, janë vendosur si kushte: a) Komision zero (0) për shlyerjen e kredisë para afatit; b) Norma e interesit më e ulët se tregu ekzistues; c. Mbulimi i kolateralit nga ana e Bashkisë të jetë në nivelet 30% – 50% dhe d. Norma interesi të depozitës me nivel më të lartë.

iv) Përsa më lart, në zbatim të nenit 4, të ligjit të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se Fondi Bashkiak i Garancisë mund të aktivizojë burimeve shtetërore në formën e garancisë mbi kreditë dhe/ose dhënien e kredive

me norma interesi të ulëta. Masa është selektive, sepse mbështetja nëpërmjet fondit të garancisë jepet vetëm për bizneset e reja apo ekzistuese, të cilave iu është refuzuar dhënia e kredisë për mungesë kolaterali në sektorë të caktuar. Natyra selektive e masës sjell ndikim në konkurrencë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 20 (pika 1), 25, 29, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Vendimi i Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 20, datë 9.4.2013 “Për zbatimin e programit të zhvillimit ekonomik dhe punësimit “Skema e fondit të garancisë” si dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë”, ka miratuar krijimin e fondit bashkiak të garancisë, pa marrë parasysh dispozitat ligjore të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, konkretisht nenin 20 “Njoftimi i ndihmës”, si dhe nenin 4 “Ndalimi i ndihmës shtetërore”, dhe në mungesë të një autorizimi paraprak nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

2. Brenda dy muajve nga data e publikimit të këtij vendimi, Bashkia e Tiranës të paraqesë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes informacion plotësues lidhur me:

- Listën e të gjithë përfituesve, të cilët kanë përfutur kredi nëpërmjet fondit bashkiak të garancisë, bashkëlidhur shumën e garancisë për secilin prej tyre.

- Një përshkrim të detajuar për përfitimet që janë krijuar nga zbatimi i skemës së garancisë.

3. Bashkia e Tiranës duhet të japë çdo informacion shtesë që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë, si edhe për çdo ndryshim të skemës së garancisë.

4. Ky vendim i dërgohet për njohje dhe zbatim Bashkisë Tiranë.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj

<sup>12</sup> Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 9.4.2013

<sup>13</sup> Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 9.4.2013, pika 2, shkronja “b”

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 44 lekë